

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7651 E premte 14 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **i** **Ditës**  
Sapo ka përfunduar faza e parë e regjistrimeve për maturantët që aspirojnë të ndjekin studimet e larta universitare. Si çdo vit, edhe në këtë vit...  
Vijon në faqen 20

Nga REZANA KONOMI  
Emri dhe tradita e mirë bëjnë gjithmonë diferencën...  


**Opinion** **i** **Ditës**  
Ditët e fundit fatmirësisht u fol në media për procesin e dixhitalizimit të transmetimeve televizive. Edhe pse ky proces ka kohë që ka nisur edhe AMA...  
Vijon në faqen 21

Nga DILFIRUS VRIONI  
Procesi "i komplikuar" i dixhitalizimit të transmetimeve



"Arta Marku, më mirë se Adriatik Llalla"  
**Donald Lu: Gjuetia për "peshqit e mëdhenj", ende e papërfunduar**

Ambasadori i SHBA: Rama, gjithnjë gati të flasë me opozitën. Vetingu, pozitiv  
Ambasadori i SHBA-ve, Donald Lu ka treguar se gjatë kohës që ka bashkëpunuar me kryeministrin Rama është zënë shpesh herë më të, por ka vlerësuar se ai në disa raste ka arritur ta bindë. "S'kam qenë dakord me Edi Ramën thujse për çdo çështje që ka arritur në tryezën e tij dhe tryezën time. Ajo që më pëlqen është që Edi Ramës ...  
Në faqen 5

## ARTAN LAME: PROCEDURA, LEGALIZOHEN SHTEPITE ME MUNGESË DOKUMENTACIONI

# NDERTIMET PARA '91, JA FORMULARI I LEGALIZIMIT

Kreu i ALUIZNI-t: Më 17 shtator nis regjistrimi, pajisen me tapi 60 mijë ndërtime në të gjithë vendin. Trualli falas deri në 300 metra katrorë



(Në foto) Kreu i ALUIZNI, Artan Lame

**ISH-KRYEMINISTRI**  
**Berisha: Ftoj Edi Ramën t'i bëjmë vetingun njëri-tjetrit**  
Në faqen 4

**LEVIZJA E LIRE**  
**Parlamenti Europian voton "pro" liberalizimit të vizave me Kosovën**  
Në faqen 17

**LISTA E RE**  
**KEMP-i, emrat e 308 personave që do të kryejnë kontroll mjekësor**  
Në faqen 9

**U DENUA NË MUNGESË**  
**Tentoi të vrasë Lulzim Berishën, rihapet çështja për Ahmet Ajetin**  
Në faqen 7

**KRYEMINISTRI**  
**Nisma e opozitës për vetingun, Rama: Do ta dërgojmë në Komisionin e Venecias**  
Në faqen 2

## Dossier nga Dashnor Kaloçi/ Dokumenti sekret për Komitetin Qendror më 1982

# "Mehmeti e zvarriti arrestimin e agjentit grek"

Sekretari i Parë i Korçës, Enver Halili: Ja mëkatet e Mihallaq Ziqishtit

NGA DASHNOR KALOÇI  
Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolete në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe sot pas 37 vjetësh vazh-



dohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutohesh; "nën frymën e fjalës së shokut Enver Hoxha ...  
Në faqen 10-11

# VETINGU I POLITIKANËVE REAGIMET

Ndryshimet në qeveri, kryeministri: Nuk jam i kënaqur me askënd, as me veten

## Nisma e PD për vetingun, Rama: Do ta çojmë në Komisionin e Venecias

"Kryeministrat e mëparshëm i morën dhuratat, unë i kam me regjistër"

**K**ryeministri Edi Rama deklaroi dje, se Partia Socialiste do të kërkojë interpretimin e Komisionit të Venecias për propozimin e kreut të PD-së, Lulzim Basha për veting në politikë. Ai u shpreh i gatshëm që të hetohet pasuria e tij, ndërkohë që zbuloi, gjatë një interviste në emisionin "Open" në Top Channel se kur kishte marrë detyrën e kryeministrit nuk gjeti asnjë dhuratë zyrtare, por të gjitha ishin marrë.

**Jeni akuzuar nga kreu i Partisë Demokratike se keni shkruar në SHBA për të bërë një tjetër vjedhje me ligj....**

Pse duhet të shkoja në SHBA ta bëja këtë? Njerëzit meritojnë shumë më tepër respekt kur komunikojmë për ta, kjo lloj gjuhe është një fyerje për shqiptarët. Të gjitha shpenzimet e mia familjare, deri tek ato më të imtat janë të deklaruara.

**Pse keni zgjedhur të heshtni për kufijtë?**

Sepse besoj që nuk bëhet fjalë për një çështje të ditës, por bëhet fjalë për një çështje të historisë sonë të përbashkët, ku i takon në radhë të parë Kosovës, i takon autoriteteve të Kosovës të përpunojnë një platformë për dialogun dhe unë jam i fundit njeri ndër shqiptarë të flas dhe të bëj komentatorin në ndërkohë që, nga njëra anë në Kosovë ka një debat mbi një ide po jo mbi një platformë, sepse një platformë s'ë kemi parë. Dhe nga ana tjetër si përfaqësues i Shqipërisë ndiej detyrimin të respektit deri në fund Kosovën dhe autoritetet e saj.

Është një qëndrim shumë i qartë Shqipëria ka detyrimin të mbështesë fuqimisht Kosovën dhe në detyrimin për të mbështetur Kosovën ka detyrën të presë dhe të ndjekë me shumë vëmendje se çfarë vetë përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës mendojnë dhe për çfarë ata kanë ndërgjegje të bien ose jo dakord. Në nuk mund të bëjmë turpin e Kosovës. Unë s'ë kam pëlqyer kurrë kur e kanë bërë të tjerët dhe asnjëherë s'kam marrë përsipër ta bëj vetë edhe kur jam keqkuptuar. Këtu luhet fati i kombit shqiptar për shumë vite që vijmë. Mund të gabohet shumë lehtë dhe të bëhen gabime.

**A keni folur me presidentin Thaçi?**

Kam folur me një pjesë të madhe të atyre që kanë dashur të flasin me mua. Kam folur edhe me të tjerë qofshin me partnerët amerikanë, partnerët gjermanë. Kam ndjesinë e fortë që ne jemi para një shansi historik që duhet ta lexojmë me shumë vëmendje. Të hysh sot në debatin politik korrigjim dhe jo korrigjim është mungesë pjekurie. Plas për ata që kanë një peshe publike. Mua si kryeministër

**Me presidentin Vuçiq keni biseduar?**

Reduktimi i debatit në këtë pikë është banalitet. Ne si shqiptarë duket të kemi



Kryeministri Edi Rama

një qasje politike. Dialogu në vetvete me Serbinë është një copë e madhe politike që ne duhet të jemi në gjendje ta përtypim me unitet dhe dinjitet.

**Përmendëm një artikullim të zotit Basha në lidhje me shpenzimet tuaja....**

Kur unë jam bërë kryeministër në godinën e kryeministrit nuk kishte asnjë dhuratë. Ndërkohë që në të gjitha kryeministritë e vendeve serioze apo normale dhuratat që vijnë për kryeministrat kur kalojnë një vlerë simbolike, p.sh., nuk është një kravatë, buton apo diçka tjetër, regjistrohen dhe qëndrojnë aty. Për herë të parë kryeministria ka një regjistër të dhuratave dhe ka dhuratat të çmuara, të cilat unë nuk i kam marrë me vete në shtëpi, por i kam lënë aty për shtëpinë shqiptar.

**Berisha i ka marrë me vetë, Nano e të tjerët?**

Këtë gjë unë po ua them siç është. A i kanë marrë, a jua kanë marrë nuk e di, por kur kam hyrë në kryeministri aty nuk kishte asgjë. Nuk kishte asnjë shenjë që kishte qëndruar dikur një kryeministër. E dyta, unë kam bërë një dasmë kur isha kryetar bashkie, e kryetar i PS-së, janë të regjistruara dhe të kthyerja të gjitha dhuratat që kanë patur një vlerë. E treta, unë do isha vërtetë i lumtur sikur të hapeshin të gjitha librat e pasurive dhe të shpenzimeve të politikanëve dhe të familjarëve dhe të krushqëve të tyre, të merreshin të gjitha shpenzimet e udhëtimit, hotelet ku kanë qëndruar, shpenz-

imet që kanë bërë, vajtje-ardhjet, lindjet, martesat, sëmundjet, të gjitha dhe mbi të gjitha të zbardheshin të gjitha burimet e të ardhurave që kanë prodhuar pasuri apo aktivitete me shpenzime të larta ose jonormale. Jam shumë i interesuar që të fillojë kjo gjë nga sarajet e mia.

**Na thoni jeni pro apo kundër propozimit të opozitës?**

Ky nuk është fare propozim i opozitës, por do vij edhe aty. Të gjitha, jo vetëm të shtëpisë ku jetoj, sa taksa janë paguar, sa ka kushtuar çfarë kam blerë dhe ku janë blerë. Unë do bëj çmos që kjo të bëhet.

Dëgjoj që ime shoqe ka përfutur truallin ku është ndërtuar shtëpia në mënyrë abuzive. Unë e di shumë mirë si është e vërteta. Unë të vërtetën mbi çdo qindarkë, e kam me letra e çdo në dispozicion të çdo gjykate, komiteti etj. Thuhet se baxhanaku i Edi Ramës ka fituar 15 mil tenderë. Çfarë duhet të bëj? T'u përgjigjem këtyre për çdo gjë. Kush do ta besojë? Nëse kjo do ndodhë para se unë t'ia lë vendim tim dikujt tjetër, do jem njeriu më i lumtur

**Jeni pro idesë së vetingut?**

**Ky është artist (për Bashën)**  
Në ç'kuptim është artist? Ky është mashtrues, nga ata që fusin dorën në kapele dhe nxjerrin zogun... por nuk kam asgjë më të keq ndaj Lulit, këtë e them me të vërtetë.

**Do ta votoni propozimin e PD për vetingun e politikanëve?**

Nëse është një qëndrim shumë i qartë Shqipëria ka detyrimin të mbështesë fuqimisht Kosovën dhe në detyrimin për të mbështetur Kosovën ka detyrën të presë dhe të ndjekë me shumë vëmendje se çfarë vetë përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës mendojnë dhe për çfarë ata kanë ndërgjegje të bien ose jo dakord. Në nuk mund të bëjmë turpin e Kosovës. Unë s'ë kam pëlqyer kurrë kur e kanë bërë të tjerët dhe asnjëherë s'kam marrë përsipër ta bëj vetë edhe kur jam keqkuptuar. Këtu luhet fati i kombit shqiptar për shumë vite që vijmë. Mund të gabohet shumë lehtë dhe të bëhen gabime.

**KOSOVA**  
Është një qëndrim shumë i qartë Shqipëria ka detyrimin të mbështesë fuqimisht Kosovën dhe në detyrimin për të mbështetur Kosovën ka detyrën të presë dhe të ndjekë me shumë vëmendje se çfarë vetë përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës mendojnë dhe për çfarë ata janë në gjendje të bien ose jo dakord. Në nuk mund të bëjmë turpin e Kosovës, - tha Rama.

Cilin veting? Ata nuk dinë as vetë çfarë kërkojnë... Të vijë njëherë të vetingu që kemi bërë ne. Ka një veting për politikanët, për lidhjen me krimin, pasurinën e tyre dhe të rrethit familjarë. Njerëzve u intereson sa të ardhura të dala nga xhepat e tyre kanë marrë në zotërim në mënyrë të paligjshme. Këta të tre do ngrënë një strukturë për të hetuar veten e tyre? Nuk është çështja që nuk jam dakord, por kjo është një farsë, nuk kuptohet se çfarë është. Veting i politikanëve janë duart... i ke të pastra apo nuk i ke?

**PD thotë që e ka gati?**

Ku e ka në kapele? Megë këta i referohen ligjit të dekriminalizimit Atua duam këta tani që thashethemet e tyre t'i kthejmë në ndryshim kushtetuese

**Një deputet kapet në përgjim me një të akuzuar nga drejtësia...?**

Prokuroria thotë që kjo nuk ka vlerë, e vendosin këta! Kjo është e gjitha një lojë e Lulit si artist për të krijuar një turbullirë që ne duam të bëjmë vetingun e politikanëve dhe ndërkohë vetingun e sulmojmë.

**Një politikan që shpërohet me anëtarë bandash duhet të jetë ministër apo deputet?**

Unë mendoj që çështja me kë shoqëroresh është çështje personale. Nëse shoqërohet me dike që kryen aktivitet kriminal t'u duhet të shkosh para drejtësisë. Kjo është një nismë kushtetuese në do t'ia çojmë Komisionit të Venecias. Luli e ka hedhur gurin. S'kemi pse zhytem 100 vetë ta nxj-

rin. Ne siç e ka hedhur gurin, do ta fusim në qese dhe do ja çojmë Komisionit të Venecias.

Nuk është veting ti thash popullit tënd që ky rri me atë dhe ky me këtë. Për gjyqtarët nuk bëhet fjalë u takove s'u takove, bëhet fjalë për kontakte të papërshtatshme. Nëse Komisioni i Venecias...

**Nëse PD e shton në projektin e vet hetimin për familjarët do ta votoni?**

Mos kujtoni se Luli do e bëjë. Monika jo e jo, ai gjyshi dixhital nuk e bën. Ajo që bën ndarjen e politikës nga korrupsioni është BKH dhe SPAK. Ne e kemi me ligj Prokurori e Posaçëm vetëm për politikanët. Këto akuzat që bëhen këtu do bien në dorën e ustallarëve. Akuzat i marrin ustallarët me partnerët ndërkombëtarë dhe i fusin në sitë.

**Ju jeni shprehur për një takim me zotin Basha...**

Do takohet me mua, por nuk i ka ardhur akoma ajo pjesë. Po sa ta lenë të tjerët. Do ta lus unë ca dhe pastaj do vijë dhe do thotë ja ku jam Romeo. Se kur do vijë në takim unë e kam shumë të qartë

**Ë pë me kë ishte në takim?**

Ka të tjera që i këndojnë tani. I vënë nuska. Shqipëria nuk mundet të jetë prehe e kësaj maskarade.

**Qëndrojmë pak në Shkodër?**

Kur zotëria ishte ministër 18 vetë nga janari në gusht, sot janë vrarë vetëm 8 vetë. Në 2013 në Shkodër janë vrarë 11 vetë nga janari në gusht, ndërsa tani janë vrarë 7 vetë. Në Elbasan kur zotëria ishte ministër i Brendshëm janë vrarë 11 vetë nga janari në gusht, ndërsa tani janë vrarë 1 vjet dhe 1 sivjet. Nuk diskutohet që ne kemi pritshmëri më mirë se kaq. Unë po them që këta nuk kanë gojë të flasin. Unë thashë që ato vrasje janë të papranueshme.

**Thuhet që janë dy familje mafioze në Shkodër që kanë mbështetje politike?**

Jo, nuk merrem fare me kontaktet. Me mund të jemi të zotë, mund të jemi të pazotë. Por ne e kemi vijën të ndarë me atë botë. Ne i jemi qepur me bukë në trashë të gjithëve.



Gjatë një seance parlamentare

**A ka deputetë të PS-së që njohin dhe mbështesin...**

Nuk kanë deputetë të PS që mbështesin këta, nuk ka shans. Edhe ai që u përjashtua ikte nga votimi, bënte sikur kështu e ashtu, kërcënonte të ulte numrin në votim për të patur të drejtën të emëronte shefin e policisë. Ka marrë fund ajo kohë që kur ka qenë Saimir Tahiri dhe me Fatmir Xhafajn që u vuiri kufirin të thana deputetëve.

**Jeni i kënaqur me punën e zotit Xhafaj?**

Në asnjë kancelari nuk jam vënë në vështirësi. Unë nuk jam i kënaqur me askënd, duke filluar nga puna ime. Unë gdhitem me ankthin çfarë do bëj sot dhe ngryeshem me ankthin se duhet të kisha bërë më shumë. S'jam i kënaqur me askënd.

**Ndryshimet në qeveri...**

Deri tani folëm për ne, mua Lulin. Unë mendoj që minutat e tjera të flasim për këta, për njerëzit. Unë kam bërë një refleksim të thellë

**Më vjen shumë mirë që jo me larg se sa 48 orët e fundit doli e dhëna për rënien e papunësisë. Kemi sot papunësinë më të ulët historike**

**Thonë që shisni kravatat...**

Nuk i shes. Më kanë ardhur dy djem të talentuar dhe më kanë marrë leje a mund t'i përdorim punët tuaja. Do t'i shes vetë, kur të largohem nga politika. Se e kam thënë do kem një jetë të tretë. Nuk do të katandisem kështu si "doktori" 80 vjeç dhe të përgojësi dyanjë. Unë nuk e lejoj veten të përfundoj si ai.

**E keni vendosur kur do largoheni?**

Nuk e di, por me siguri do të largohem shumë më përpara se të vijë dita që së largu të mund të mëndohet se do të bëhem si puna e Berishës dhe sinqerisht më vjen keq për të.





Bojkoti, opozita mblidhet në Durrës, ultimatum Ruçit për vettingun në politikë

# Basha paralajmëron fakte tronditëse: Qeveria, e lidhur me krimin

## PD i hap derën Idrizit: Të largojmë Ramën

Valentina Madani

Lulzim Basha paralajmëroi dje nga Durrës publikimin e fakteve tronditëse, që sipas tij faktikisht lidhjet e qeverisë me bandat dhe krimin. Kreu i PD-së në mbledhjen paralele të "Kuvendit" i dha një ultimatum kryetarit të Kuvendit që të botojë projektligjin e opozitës për vettingun në politikë. Basha akuzoi kryeparlamentarin Gramoz Ruçi, se me urdhër të Ramës nuk po boton 'online' në faqen e parlamentit, projektligjin e depozituar nga opozita për vettingun e politikaneve. Edi Ramës i kërkoi sërish votën në parlament, duke përfshirë çdo mundësi negociimi me të për nismën kushtetuese të opozitës. "Nxitojnë të fusin ligjin 'Rama-Fusha' dhe vjedhjen e pasurive të shqiptarëve, por e përdorin Kuvendin si 'kuplara' personale të Ramës, duke refuzuar një detyrim ligjor, transparencën. Politikanët t'i nënshetrohen vettingut, si gjyqtarët, prokurorët dhe policët. I kap këtë ultimatum Ruçit: Mos u sill si pronar por boto 'online' propozimin, ta shohin shqiptarët projektligjin. Rama nuk e do vettingun politik, sepse ai ka për qëllim të largojë nga parlamentin, nga qeveria dhe nga zyrat e larta të shtetit politikanët e korruptuar dhe të lidhur me krimin. Për këtë arsye ka lançuar një fushatë paniku, plot me gënjeshtërta dhe me mashtrime të trasha e pretendime false e të gënjeshtërta", theksoi z.Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Durrës

të vendosjes së interesit të shqiptarëve, të interesit të qytetarëve shqiptarë dhe interesave kombëtare mbi interesat e bandës në pushtet dhe të formulimit të zgjidhjeve të përbashkëta për t'i dhënë fund emergjencës kombëtare, ku e ka fund vendin Edi Rama dhe banda me të cilën ai bashkëqeveris", deklaroi Basha.

### ISH-TË PËRNDJEKURIT

Kreu i PD, Lulzim Basha, paralajmëroi se do të anuloi ligjin për ish-të përndjekurit sapo të vijë në qeveri. Nga Durrësi, ku opozita zhvilloi mbledhjen e saj, ai tha se kjo që po u bëhet familjarëve të ish-të përndjekurve është një barbari. "Dua t'ju them të përndjekurve politikë se ajo që ndodh sot në Kuvend është moralisht një barbari e dytë mbi ju dhe familjet tuaja. Jo thjesht dhe vetëm aspekti financiar, por futja e duarve të rilindjes, tregon se nuk ka asnjë sens pengese ndaj vrasjeve dhe burgosjeve të prindërve dhe gjyshërve tuaj. Akti i parë në ditën e dytë të mazhorancës së re do të jetë anulimi i këtij ligji, i këtyre amendimeve kriminale, që sot pasardhësit e Enver Hoxhës po kalojnë në folenë e krimin të drejtuar nga kriminelët e vjetër dhe të rinj. Ne do ta zhbëjmë këtë dhe ju kërkojmë të bashkoheni në aksionin politik, sepse kështu do t'i shërbeni dinjitetit tuaj dhe të të gjithë shqiptarëve", tha kreu i PD.

### RAPORTIMI

Në mbledhjen e djeshme të opozitës në Durrës mësohet se kanë raportuar drejtuesit e grupeve të punës, që ka ngritur opozita në kuadër të aksionit opozitar, Alibeaj, Salianji, Tabaku dhe Luan Rama.

e fatit dhe për t'i përdorur ato për aktivitetin kriminal, që nuk është më mbjellja e kanabisit, ndonëse vazhdon. Por, është pastrimi i parave të pista të kokainës, heroinës dhe aferave korruptive të Ramës dhe bandës së hajdutëve të tij në qeveri", deklaroi z.Basha.

### FTESA

Kreu i opozitës, Lulzim Basha iu përgjigj pozitivisht kreut të PDIU-së, Shpëtim Idrizi, për të bashkëpunuar në opozitë. Ai tha se e mirëpret këtë kërkesë, ba-

### VIZITA

Kreu i PD-së u shpreh se kryeministri Edi Rama "po fshihet" prej 5 ditësh në Nju Jork për një arsye të caktuar: "Rama ndodhet në Nju Jork për të vjedhur territorin e Konsullatës Shqiptare atje, pasi do të ngrejë një grataçelë".

zuar mbi parimet dhe objektivat që opozita ka shpallur për të çliruar vendin nga bashkëqeverisja me krimin. Ai njoftoi se do të nisin bisedimet me Idrizin për të formuluar strategjinë për largimin e Ramës nga pushteti. "Në këtë kuadër, mirëpres kërkesën e Partisë për Drejtësi Integrim dhe Unitet, për të nisur bisedimet me Partinë Demokratike dhe opozitën, bazuar në parimet dhe objektivat e shpallura për çlirimin e vendit nga bashkëqeverisja me krimin,



## Aksioni opozitar, Kryemadhi: Do ketë surpriza, Rama të thotë nëse është pro vettingut

Kryetarja e LSI-së paralajmëroi dje një axhendë shumë aktive të aksionit politik opozitar. "Axhenda do të jetë shumë aktive, e pabesueshme dhe e surprizueshme jo vetëm për qeverinë, por edhe për gazetarët", tha Monika Kryemadhi pas takimit me partitë opozitare në Durrës. Duke iu përgjigjur akuzave të Taulant Ballës nga salla e parlamentit se opozita i druhet vettingut nga ndërkombëtarët, Kryemadhi u shpreh:



### ASTRIT PATOZI

"Nuk më pengon asgjë të them se, në rast se Basha e ka seriozisht sfidën apo projektin e vettingut, unë do ta mbështes në të gjitha rastet. Por, dyshoj të ky seriozitet, sepse kam parë zhvillimet pas lançimit të idesë, që më lënë një shije të keqe", deklaroi Patozi.

"Kjo është qesharake. 'Toyota Yaris' nuk ishte e opozitës. Ajo ishte e Taulant Ballës. Kështu që s'ka pse t'i trembet opozita vettingut. Opozita e ka bërë vettingun e saj. Ata të thonë janë pro apo kundër vettingut. Dhe kjo është mëse e qartë. Shqiptarët presin me padurim pastrimin e klasës politike nga ata që merren me 'Toyota Yaris', nga ata që merren me trafikimin e kokainës nga Kolumbia dhe të gjitha segmentet e tjera kriminale, të cilët kanë uzurpuar dhe kanë grabitur jetën e shqiptarëve. Kjo është mëse e qartë dhe shqiptarët e kanë shumë të qartë. Çdo aludim apo fshehje emocionale që ata kanë, apo makth brenda vetes së tyre e kanë të pamundur ta shmangin duke u shfokusuar. Opozita është mëse e qartë në aksionin e saj politik. Ne po presim nëse janë pro apo kundër vettingut të politikës dhe ndërkohë vazhdojmë aksionin dhe axhendën tonë politike", tha Kryemadhi.

### PARALAJMËRIMI

Në mbledhjen e jashtëzakonshme të grupeve parlamentare opozitare në Durrës, kryetari i PD, Lulzim Basha paralajmëroi se nga sot do të publikohen fakte që ai i quan tronditëse, për ndikimin e ministrave duke i lënë lojërat e fatit nën kontroll të kriminelëve. Deklarata e Bashës erdhi në momentin kur parlamenti rrezoi dekretin e presidentit për ligjin e tatimit mbi të ardhurat. "Duke nisur që nesër (sot) PD do të publikojë fakte tronditëse, që tregojnë sesi Rama dhe Fatmir Xhafa kanë përdorur pushtetin politik për të ndihmuar bandat e krimin të organizuar për të shtënë në dorë lojërat

## Ligji për ish-të përndjekurit, Tabaku: Paratë do shërbejnë për familjet oligarke

Mazhoranca votoi dje në parlament ligjin për ish-të përndjekurit politikë me 74 vota, ndërsa opozita nuk ishte e pranishme në punimet e parlamentit. Nga Durrësi ku u zhvillua takimi i radhës i opozitës, deputetja e PD, Jorida Tabaku deklaroi se, "kjo mazhoranca po gënjën, pasi ka ulur buxhetin për këtë kategori. Vesi del me shpirtin. Kjo mazhorancë do të vazhdojë të gënjëjë për sa kohë qëndron në pushtet. Kanë buxhetuar 2 mld lekë më



pak para për ish-të persekutuarit dhe kanë kompensuar 43 mijë të përndjekur më pak se sa e njëjta periudhë e

qeverisjes demokratike. Kjo është e vërteta që lexohet në librat e qeverisë dhe jo gënjeshtër që del nga goja e qeveritarëve. Ligji i sotëm që do të miratojmë është vetëm një tjetër srollatje që do të vunojë dhe do t'i ulë kompensimet e të përndjekurve, duke përdorur paratë e tyre për koncesione tek familjet oligarke. Shifrat janë të qarta! Nuk mund të presim më shumë. Ne nuk kishim asnjë iluzion! As të përndjekurit tashmë", deklaroi zj.Tabaku.

## SITUATA POLITIKE REAGIMET

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha, i ftuar mbrëmë në studion e "Opinion" përballë një paneli gazetarësh kërkoi ndëshkimin përmes ligjit të politikanëve që kanë bërë pasuri me paratë e shtetit. Ai deklaroi se vetingu për politikanët është një domosdoshmëri për nivelin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës në Shqipëri. Ideja për një kontroll mbi politikanët, shihet nga ish-kryeministri si domosdoshmëri për shkak se askush nuk ka më shumë mundësi për të përdorur pushtetin për interesa personale se sa politikanët. Berisha tha se vetingu është i dobishëm për të monitoruar pasuritë e politikanëve. Ai u shpreh se vetingu është i vetmja mjet për të gjurmuar kullat. Në lidhje me mekanizmin që do krijohet për të funksionuar, Berisha tha se nuk është kundër edhe pranisë së ndërkombëtarëve si garant për funksionin e tij në politikën shqiptare. Ish-kryeministri deklaroi se vetingu do kontrollojë pasuritë dhe lidhjet me krimin. "Unë e konsideroj një rendësi të madhe këtë ligj, pasi 100 herë i kam thënë vetes, duke parë formularët e prokurorëve, gjykatësve dhe policëve, po politikanët? Këta kanë shumë pushtet dhe mund të bëjnë pasuri të paligjshme. Vetingu i zbulon të gjitha. Si nuk mund të ketë veting për sarajet në Surrrel. Vetingu do gjejë kullat, do gjejë palatet", theksoi z.Berisha. Lidhur me atë se kush duhet ta bëjë vetingun e politikanëve, Berisha u përgjigj: "Do ta përcaktojnë ligji". Pyetja ka kemi frikë që ky veting të "djeg" dhe ish-bashkëpunëtorët tuaj, ish-kryeministri u përgjigj: "Absolutisht çdo njeri që ka fshehur dhe ka bërë pasuri me paratë e shtetit le të përballtet dhe të marrë atë që meriton. Për veten? 1000 vetingje po deshët". Ish-kryeministri sfidoi pasardhësin e tij teksta e ftoi që t'i bëjnë vetingun njëri-tjetrit. "Rama po të jetë burrë mos të marrë shaminë e lotëve dhe të vij të përballtet. T'ia bëjmë vetingun njëri-tjetrit". U shpreh z.Berisha. Ndër të tjera Berisha tha se me Edi Ramën në pushtet opozita nuk do të fitonte kurrë zgjedhjet, pasi ato sipas tij nuk do të ishin të lira. "Nuk mund ta krahasoj me opozitën time. Të pretendosh që tjetri të ketë imitimin tënd, do ishte shumë e padrejtë. A ka bërë opozitë? Pa diskutim që ka bërë opozitë të fortë. Unë do bëja gjithçka t'i çoja patkonjtë Edi Ramës qoftë edhe me mjetet që ju

Kufijtë, ish-kryeministri: Rama ishte dakord dhe nuk e kundërshtoi ndarjen e Kosovës

# Nisma e opozitës, Berisha: Nuk u trembem as 1000 vetingjeve

## "Vetingu nga ndërkombëtarët? Pa asnjë hezitim"



### ZGJEDHJET

"Opozita me Edi Ramën nuk vjen kurrë në pushtet. Armik më të egër pas Enver Hoxhës nuk ka. Edi Rama nuk pranon kursesi votën. Ai duhet nxjerrë prej leckash nga zyra", - nënvizoi ish-lideri i PD-së.

Bild. Është sot një nga njohtësit më të mirë të rajonit. Në një editorial që botoi tha që Rama ishte dakord dhe nuk e kundërshtonte këtë ndarjen e Kosovës. Nuk ishte artikulli i Baton Haxhiës ky, por ishte Karl Bild"- theksoi z. Berisha. Ish-kryeministri u shpreh pro një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë, por jo shkëmbim-it të territoreve mes dy vendeve. Berisha deklaroi se ministri serb Ivica Dačić, ka kërkuar që shqiptarët e Preshevës të shkojnë me Kosovën. Berisha u shpreh se pas dhunës në Preshevë në janar të vitit 2013 Ivica Dačić u ka thënë shqiptarëve të Preshevës se policia ka bërë gjënë e duhur pasi ata nuk shkuar me Kosovën. "Në konfliktin që ndodhi shkoi u fut Policia, i rruhu i zhëpëi policia, ja u hodhi librat e fëmijëve dhe i shqelmoi si nazistë dhe unë reagoja për ashpërsinë më të madhe. Shkoi Ivica Dačić dhe u tha mirë ja u bëri policia ju se nuk po shkoni me Kosovën", u shpreh Berisha. Sipas tij marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë është një projekt serb dhe jo ashtu siç është komunikuar në media. Berisha tha se dy apo tre argatët të Beogradit kanë marrë flururin dhe ua shesin shqiptarëve si projekt të tyre, a thua se shqiptarët janë njerëz pa memorie historike. Ai përmendi se rajoni i Ballkanit ka shumë minoritete, megjithatë këto nuk janë problem. Sipas Berishës, problemi i vërtetë janë mazhorancat në këtë rajon, dhe jo minoritetet. Ish-kryeministri deklaroi se presidenti turk Recep Tayyip Erdogan është një njeri që ka ndikim në Shqipëri për shkak të lidhjeve të ngushta me kryeministrin Edi Rama. Sipas Berishës fuqia apo ndikimi i presidentit turk në Shqipëri, buron pasi Erdogan ka bërë synet politik Edi Ramën.



Ambasadori i SHBA-ve, Donald Lu me ish-kryeministrin Sali Berisha

### Vetingu në politikë, Balla: Opozita kërkon të dobësojë SPAK e BKH

Kreu i deputetëve socialistë, Taulant Balla shigjetoi sërisht kryeopozitarët Luzlim Basha e Monika Kryemadhi për nismën e propozuar prej tyre, që vetingu t'i nënshtrohen edhe politikanët. Sipas Ballës, nisma e opozitës kërkon që politika shqiptare të bëjë vetingun e vetvetes, por kjo gjë nuk mund të ndodhë, pasi reforma në drejtësi e votuar dy vite më parë në Kuvend ia njeh këtë të drejtë SPAK-ut dhe BKH-së. Balla tha se e dinte shumë mirë frikën e tyre, por se roli ndërkombëtarëve edhe në këtë proces është i pashmangshëm. "Nisma jote do të thotë që politika të votojë vetveten, ndërsa sipas SPAK, vetingun nuk e bëjnë dot ca kukulla të politikës, por ndërkombëtarët. Juve s'ka nevojë t'ju kesh përballë për të kuptuar hallin tuaj. E di hallin që kemi, nuk duam tha njëri prej jush që vetingun ta bëjnë ndërkombëtarët, se na janë bërë si guvernatorë nga një tjetër. Jo, as ekspertët e SHBA-ve dhe as ambasadori i BE nuk janë guvernatorë, por miq shumë të mirë të Shqipërisë. Ne me atë që kemi votuar u kemi dhënë atyre të drejtën edhe për të na hetuar", deklaroi z.Balla.

**SFIDA**  
Ish-kryeministri sfidoi pasardhësin e tij teksta e ftoi që t'i bëjnë vetingun njëri-tjetrit. "Rama po të jetë burrë mos të marrë shaminë e lotëve dhe të vij të përballtet. T'ia bëjmë vetingun njëri-tjetrit". U shpreh z.Berisha.

### Miratohet ligji për ish-të përndjekurit

## Kuvendi rrëzon dekretin e Metës, Braçe: Veting për pronarët e lojërave të fatit

Mazhoranca qeverisë rrëzoi dje dekretin e Presidentit Meta për tatimin mbi të ardhurat për lojërë të fatit. Dekreti është rrëzuar me 74 vota, ndërsa opozita nuk ishte e pranishme në seancë, pasi vijon jopartitë dhe parlamentit prej njsjes së sesionit të ri në datë 3 shtator. Ministri Ahmetaj dhe kreu i Komisionit të Ekonomisë, Braçe rrëzuan argumentet e presidentit. Braçe foli për dekretin e presidentit mbi të ardhurat nga tatim-fitimi. Ai theksoi se në vitin 2006 kur erdhi PD në pushtet, tatimin e fitimit e bëri 0%, ndërsa për kompanitë 20%. Sipas Braçes, PD i ka favorizuar lojërë të fatit dhe



tashmë duhet të merren masa për ndalimin e të rinjve, të cilët frekuentojnë këto lojërë fati dhe pika bastesh sportive. "Në tri raste qeveria ka vendosur të heqë dorë nga fitimet e bizneseve, ndërsa presidenti pretendon se Kuvendi ka ulur tatim-fitimin mbi lojërë të fatit. Partia Demokratike ka akuzuar mazhorancën se ka

favorizuar lojërë të fatit. Barra fiskale nuk ka ndryshuar, është shumë e qartë që propaganda është e PD-së, nuk e bëjnë me ne. A kemi probleme me lojërë të fatit? Kemi probleme në zbatimin e ligjit, kemi probleme me moshën e personave që futen atje. Të rinjtë i gjen me tepri në pikat e basteve sportive. Ligjin për cakton ndalimin e reklamimit të lojërave të fatit në fasadat e tyre", tha z.Braçe. Mazhoranca miratoi dje edhe ligjin e ri për ish-të përndjekurit, me kriteret e reja që parashikohen. Ndërkohë që sërisht u shtynë projektligji për Magjistratën dhe ai për Kodin Rrugor që kërkojnë 84 vota.

Hashim Thaçi. I pyetur për qëndrimin e Ramës që deri tashmë ka heshtur për këtë çështje, Berisha tha se ai është shprehur për këtë çështje të cilën e mbron në prapaskenë. "Rama nuk ka heshtur. Rama me pabesinë e tij flet gjithmonë. E njoh mirë Karl

nxjerrë prej leckash nga zyra", nënvizoi z.Berisha.  
**KORRIJIMI I KUPIJVE**  
Ish-kryeministri Sali Berisha komentoi gjatë për një marrëveshje të mundshme mes Serbisë dhe Kosovës dhe idesë së presidentit kosovar

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Zyra për barinorë "Besi 2010"

SHPLLJE ANKANDI

Më datë 16 tetor 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyrë për barinorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shpërndarjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq 1, ZK.8603, me cirmim fillestar 3307500 lek; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, me cirmim fillestar 25156600 lek

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUIŠ 397201218L)

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644





**A**mbasadori i SHBA-ve, Donald Lu ka treguar se gjatë kohës që ka bashkëpunuar me kryeministrin Rama është zënë shpesh herë më të, por ka vlerësuar se ai në disa raste ka arritur ta bindë. "Skam qenë dakord me Edi Ramën thuasje për çdo çështje që ka arritur në tryezën e tij dhe tryezën time. Ajo që më pëlqen është që Edi Ramës i pëlqen një debat i mirë. Zihemi për shumë gjëra. E pranoj para jush se ka pasur shpesh raste kur më ka bindur për qëndrimin e tij.", -ka thënë Lu në emisionin "Real Story" të gazetarit Sokol Balla.

**A mendoni saktësisht tre vjet e tetë muaj më parë se do të arrihni apo do të përfshiheshit në kaq shumë gjëra në këtë vend të vogël?**

Është diçka shumë e pazakontë që të huajt përfshihen kaq shumë në jetën e një vendi dhe ne, në komunitetin diplomatik, jemi munduar të ndihmojmë dhe të mbështesim, por arritjet e vërteta kanë qenë të gjitha shqiptare. Ajo që kam parë këtu është mbresëlënëse. Flasin për reformën në drejtësi, po, por edhe për largimin e aq shumë kriminelëve nga parlamenti dhe bashkitë, zgjedhjet që u zhvilluan në mënyrë paqësore dhe konkurruese, dhe vendimi e qershorit për hapjen me kusht të bisedimeve për anëtarësimin me Shqipërinë -ka qenë lajm i madh për shqiptarët. Populli shqiptar duhet të ndihet shumë shumë krenar.

**Cili është dëshmtimi më i madh në këto tre vjet e tetë muaj në këtë vend?**

Nuk do të thosha është një dëshmtim, por është diçka ende e papërfunduar. Kam folur çdo javë mbi gjyqin për peshqit e mëdhenj dhe dua ende të flas, sepse është vërtet e rëndësishme për popullin shqiptar.

**Prandaj ka peshq edhe në corapet tuaja se e pashë...**

Vesha corapet e mia të posaçme që t'i shihni. Është më rëndësi se qeveria e tyre, policia e tyre, prokuroria e tyre janë vërtet seriozë për luftën kundër krimit të organizuar. Pata një bisedë shumë të mirë me drejtorin e përgjithshëm të policisë Ardi Veliu javën e shkuar. Kanë punuar shumë fort se bashku me prokurorët për të ngritur task-forcën për forcën e ligjit. Po punojnë sot shumë ngushtë me ligjzbatues amerikanë, gjermanë, italianë, francezë, grekë, spanjollë dhe kjo ka çuar në sukses reale. Kemi parë arrestimin e Arbër Çekaj, arrestimin e Met Kananit; janë dy trafikantë droge të arrestuar në Spanjë. Vetëm këtë javë pamë trafikantë të arrestuar në Itali dhe Gjermani. Kjo është e rëndësishme, por duhet të jetë vetëm fillimi. Ka shumë më tepër punë për të bërë dhe më vjen pak qej se nuk do të kem mundësi të jem këtu për t'i parë gjithë rezultatet e asaj pune.

**Kjo është një prej gjërave për të cilat jemi bërë gjithnjë e më skeptik në javët apo muajt e fundit. Shohim shumë aktivitet kriminal...**

Po... dhe shohim se këto, le të themi, sipërmarje kriminale kanë shumë para. Mendoni se qeveria, autoritetet do të jenë në gjendje ta luftojnë këtë valë në rritje të kriminalitetit në vend?

Jo, dhe Lialla, u bë pak personale, mendoj?

Po përsëris atë që kam thënë më parë: nuk kam asgjë

Ambasadori i SHBA në ikje, rrëfen "zënkat" me Ramën e mendimin për Tahirin e Xhafajn

# Donald Lu: Gjuetia për 'peshqit e mëdhenj', ende e pa përfunduar

"Jam i skandalizuar që Lul Berisha lirohet herët nga burgu"



Mendoj se do të jenë në gjendje, por cilido prej ambasadorëve të vendeve të BE-së dhe unë kemi thënë e përsëritur se kjo luftë e dhunshme, kjo luftë midis grupeve të trafikut të drogës mund të vazhdojë; mund të rritet derisa policia, prokuroria dhe gjykatësit të kenë kurajën për të arrestuar këta njerëz shumë të rrezikshëm. Kjo luftë kundër krimit të organizuar është e shtërmadhe dhe do të kërkojë sakrificë reale nga qeveria. Unë, për vete, jam i skandalizuar që dy vjet e gjysmë pasi qeveria greke nxori urdhër-arrestin, ende nuk e kemi kapur Klement Ballin. Jam i skandalizuar që Lul Berisha lirohet herët nga burgu dhe që mund të ecë i lirë nëpër rrugët e Durrësit. Dhe jam i skandalizuar që këtë javë që kemi gjyqin e Shullazit, ku Shullazi vetë ka kërcënuar gjykatësit dhe prokurorët, aq sa prokurorët as nuk shkojnë në gjyq. Si ka mundësi që ky vend të ecë përpara kur ndodhin këto gjëra? E di që Fatmir Xhafaj dhe Arta Marku dhe Ardi Veliu do të jenë të afër të vënë këta kriminelë pas hekurave.

**Citohet deklarata e ish-kryeministrit Berisha**

Dr. Berisha ka do të drejtë të ngrej pyetje lidhur me Z. Lialla dhe marrëdhëniet e tij me partnerët ndërkombëtarë. Është normale. Dhe mendoj se Dr. Berisha, si personi që e emëroi Z. Lialla si prokuror të përgjithshëm, ndoshta ka një ndjenjë përgjegjësie për veprimet dhe reputacionin e Z. Lialla. Por do të përsëris atë që kam thënë më parë, që është se unë jam një zyrtar qeveritar; deklaroi pasurimë time çdo vit tek qeveria; e kam bërë për 27 vjet, në mënyrë transparente dhe besnike. Z. Lialla, nga ana tjetër, dikush që vetë po akuzohet për pastrim parash dhe korrupsion, më ka akuzuar mua për sjellje të përshtatshme lidhur me një kompani, e cila në atë kohë kishte investime madhore amerikane. Nëse ndokush dyshon për qëllimet e mia në lidhje me atë kompani apo Z. Lialla, duhet të lexojnë letrën që unë i shkrova Z. Lialla. A e ka bërë publike letrën. Le t'ia thotë se unë, ambasadori i SHBA, i bëj thirrje Z. Lialla të respektojë ligjin. Dhe sigurisht, kjo mund t'i duket skandalozë dikujt që në mënyrë rutinë injoron ligjet e këtij vendi.

**Nuk e kishit për Sali Berishën?**

Kisha parasysht Adriatik Lialllën.

**Po në lidhje me akuzat në vitet e fundit, që kur fillor reforma, lidhur me ju dhe Sorosin, a ka ndonjë gjë reale këtu?**

Asnjëherë nuk është ngri-

tur ndonjë pikëpyetje serioze lidhur me mua në Washington për shkak të këtyre artikujve. Ne e dimë dhe ata e dinë që këto janë artikuj që vijmë nga lobistë të paguar të partive politike në Shtetet e Bashkuara.

**Po për Sali Berishën, ç'mendoni?**

Pata një takim lamtumirë shumë të këndshëm me Sali Berishën dhe. Është një ish-president dhe ish-kryeministër i mirënjohur i këtij vendi. Nuk është më kreu i Partisë Demokratike, por është ende një zë me peshë në Shqipëri. Është dikush që, sidomos në opozitë, kur thotë diçka, njerëzit dëgjojnë. Ndaj i kam qenë mirënjohës që ka pasur vërtet vullnetin për t'u ulur me mua, kur kemi qenë dakord dhe kur nuk kemi qenë dakord dhe për të pasur një dialog shumë konstruktiv dhe të mirë.

**Pse duket sikur reforma në drejtësi ka hyrë në një ngjerc ose të gjitha partitë politike nuk duken fort të interesuara për të kontribuar më tej për atë reformë, sidomos kur flitet për zgjedhjen apo përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj dhe anëtarëve të institucioneve të reja?**

Kanë ende frikë. Ishin të frikësuar në 2016-ën, janë të frikësuar edhe tani. Por shih rezultatet që janë arritur tashmë nga reforma - 20 gjyqtarë dhe prokurorë u dorë hoqën, 23 janë shkarkuar nga KPK, komisionet e vetingut, 27 janë konfirmuar. Një total prej 70 zyrtarësh që i janë nënshtruar këtij procesi në gjashtë muajt e fundit. Është një rezultat shumë i mirë për popullin shqiptar. Dhe faza e ardhshme është edhe më e thellë. Keni ngritjen e KLP, KLGJ dhe krijimin e prokurorit të pavarur SPAK dhe hetuesve të BKH. Kjo u kall frikë në zemër kreerëve të krimit të organizuar dhe politikanëve të korruptuar.

**Por tani Lulzim Basha do të ashtu-qafturin veting i politikanëve. Mendoni se ka nevojë ndërkohe që kemi këtë procesin që vazhdon të ndërtime të BKH dhe SPAK, të cilat në fakt do të përqendrohen tek lufta kundër korrupsionit mes politikanëve?**

Mendoj se ka edhe një tjetër formë vetingu që kemi në demokraci. Ju votoni çdo dy vjet, unë votoj çdo dy vjet si amerikan dhe u kërkojmë llogari zyrtarëve tanë të zgjedhur. Ky është një formë vetingu. Opozita ka vënë në tavolinë një propozim që e konsideroj interesant. Në Amerikë kemi shprehjen, "djalë qëndron tek hollësitë," dhe po studiojmë hollësitë e propozimit të tyre tani dhe kryeministri juaj Edi Rama ka thënë tashmë se ai dhe

Partia Socialiste janë gati tani të fillojnë negociatat mbi bazën e propozimit të tyre. Le të shohim se çfarë janë në gjendje të arrijnë ato negociata.

Ajo që di është që Kush-tetuta juaj mandaton që nëse një parti apo individë paraqesin një amendament kushtetues, duhet të ketë një proces në komisione, sipas kushtetutës, ku diskutohet amendamenti dhe ndonjë ndryshim në të; e di që ky proces negociatash po vjen dhe nxis qeverinë dhe opozitën të jenë seriozë në përqasjen ndaj asaj që mund të arrijnë të bëjnë bashkë për këtë propozim shumë interesant.

**Gjatë tre vjet e tetë muajve keni qenë shumë kritik ndaj qeverisë si dhe zyrtarëve specifikë, zyrtarëve të lartë të qeverisë. Atëherë pse kjo nuk e ka ndaluar një pjesë të medias dhe faktorëve politikë këtu që t'ju etiketojnë si person që mbështet Edi Ramën?**

Nuk mendoj se është surprizë për ju dhe ndonjë nga shikuesit tuaj se skam qenë dakord me Edi Ramën thuasje për çdo çështje që ka arritur në tryezën e tij dhe tryezën time. Ajo që më pëlqen është që Edi Ramës i pëlqen një debat i mirë. Zihemi për shumë gjëra. E pranoj para jush se ka pasur shpesh raste kur më ka bindur për qëndrimin e tij. Ka pasur pak raste kur e kam lëvizur unë atë nga pozicioni pakëz, por në fund, është dikush që është gati të kërkojë zgjidhje krijuese. Kërkon mënyra krijuese për të dalë nga problemet dhe më pëlqen edhe që është gjithnjë gati të flasë me opozitën. Dhe kjo nuk ka qenë gjithmonë e vërtetë në Shqipëri.

**Saimir Tahiri. Ende pret gjyqin, por duket nga fjalët tuaja se e kemi marrë vendimin, që është fajtor, pse?**

Nuk jam dakord për këtë. Nuk e kemi paragjykuar Saimir Tahirin. Ajo që kam thënë dhe do e përsëris është se shumë shqiptarë, dhe unë, mendojmë se ka prova reale që i sheh në media çdo herë që del kjo çështje, për manipulim politik të çështjes. Tani, ne besojmë, qeveria e SHBA beson se kjo çështje është një mjaftueshmë e rëndësishme sa meriton të vendoset në gjykatë nga një gjykatës që ka kaluar vetingun, sipas provave, dhe jo sipas presionit politik. Këtë kërkojmë. Mbështesim përpjekjet që kjo të shkojë përpara në mënyrë transparente. Z. Tahiri ishte ministër kur këto krime pretendohen të jenë kryer. Është logjike të mendohet se kjo çështje, në fakt, mund të jetë një nga të parat që do të gjykohej në një gjykatë të SPAK, nga gjyqtarë dhe prokurorë që kanë kaluar vetingun. Kjo është diçka që do ta mbështesim fort.

## OPOZITA

I kam këshilluar të gjithë miqtë e mi, të cilët punojnë në Partinë Demokratike, dhe së fundmi edhe në LSI, se është shumë e rëndësishme që opozita të shfaqë një front të bashkuar. Dhe që ata njerëz, të cilët e ndiejnë veten mënjënjë partisë, sidomos asaj Demokratike, të gjejnë rrugën sërish brenda partisë. Partia Demokratike është një pjesë krenare dhe e fuqishme e kësaj demokracie, dhe ajo duhet të ketë sukses që edhe demokracia të ketë sukses.

## AMBASADORJA E RE

"Kathy Kavalec do të jetë një ambasadore e shkëlqyer në këtë vend. Unë nuk di të ketë probleme në Senat, madje kam shpresën që mikja ime Kathy do mund të ketë një seancë dëgjimore në Senat këtë muaj. Mendoj se kjo do të ishte mirë për të, por do të ishte mirë edhe për Shqipërinë. Unë besoj se ajo do të jetë akoma dhe më e ashpër se Don Lu apo Romana Vlahutin apo të gjithë ne, mbi të njëjtat çështje, reformën në drejtësi, luftën ndaj krimit të organizuar dhe luftën ndaj korrupsionit në nivele të larta", -u shpreh Lu.



Operacioni "Preçizioni", 32-vjeçari u kap në Turqi dhe u lirua për mungesë provash

VLORE

Një anëtar i bandës së Met Kananit, i cilë suar si "Eskobarit i Ballkanit" është arrestuar dhe nga policia e Vlorës gjatë një operacioni të madh antidrogë. Bëhet fjalë për Besmir Lupin, i arrestuar në mars të këtij viti në Turqi. Në atë kohë u prangos edhe vet Met Kanani, kreu i grupit të trafikimit ndërkombëtar të drogës, teksa priste një ngarkesë prej 1.1 tonë kanabis, e cila vinte nga Shqipëria. 32-vjeçari kishte rolin e transportuesit të drogës në grupin kriminal të Met Kananit, i cili njihet ndryshe në Turqi si "Met shqiptari". Burime zyrtare nga Policia e Shtetit dhe bënë me dije se, "nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në vijim të operacionit ndërkombëtar antidrogë të koduar "Preçizioni", në kuadër të procedimit penal nr.54, viti 2017, u bë ndalimi i shtetasit Besmir Lupi, 32 vjeç, lindur dhe banues në Vlorë. Ndërkaq, mësohet se vënia në pranga e Lupit u bë pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë ka dërguar urdhrin për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, nr.96, datë 11.05.2018, e cila i ka caktuar masën e sigurimit personal "Arrest me burg" për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve", kryer në bashkëpunim dhe "Krijimit të grupit të strukturuar kriminal". Në kuadër të këtij operacioni - sqaroi policia - është arrestuar më parë nga policia turke edhe kreu i grupit të strukturuar kriminal, Met Kanani". Emri i Lupit është bërë publik që në 11 maj 2018, në kuadër të operacionit "Preçizioni", ku u shkatërrua grupi kriminal i "Eskobarit të Ballkanit", Met Kanani. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë

# Trafiku i drogës, arrestohet në Vlorë bashkëpunëtori i "Eskobarit të Ballkanit"

## Besmir Lupi kishte rolin e transportuesit të lëndëve narkotike në grupin kriminal të Met Kananit

**GRUPI KRIMINAL I MET KANANIT**

Grupi kriminal i supertrafikanit Met Kanani përbëhej nga 18 anëtarë. Supertrafikanit Met Kanani u kap në Turqi në mars të këtij viti, me 1.1 tonë kanabis. Pas kësaj së "Eskobarit të Ballkanit", operacioni u shtri edhe në Shqipëri, në muajin maj të këtij viti, ku u arrestuan 13 pjesëtarë të këtij grupi kriminal. E gjithë banda kriminale përbëhej nga 66 persona të kombësive të ndryshme, pjesa dërrmuese e të cilëve tashmë janë arrestuar.



34-vjeçari i arrestuar, Besmir Lupi

**LINJAT E TRAFIKUT TË DROGËS**

Sipas burimeve nga Policia e Shtetit, në maj të këtij viti, grupi kriminal i Met Kananit vepronte në linjat e trafikimit të heroinës, Turqi-Greqi-vendet e BE-së, si dhe Turqi-Maqedoni-Shqipëri-vendet e BE-së. Një tjetër aktivitet kriminal, i zbuluar nga hetimet ishte trafikimi i kokainës nga vendet e Amerikës Latine përmes vendeve të Ballkanit në Shqipëri dhe vendet e BE-së. Në operacionet e zhvilluara më herët edhe në Itali, Greqi, Turqi e Shqipëri, bandës në fjalë i është sekuestruar mbi 8.4 tonë kanabis me vlerë tregu 10 mln euro.



Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë për veprime të mëtejshme procedurale. Besmir Lupi ishte një prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të Met Kananit dhe një personazh i njohur për policinë. Ai ish-

te skafisti i grupit kriminal, i cili transportonte kanabisin në drejtim të Turqisë, por edhe Italisë. Lupi u arrestua në Turqi si pjesëtar i grupit kriminal të Kananit, por u la i lirë për mungesë provash. Ndërsa në Sh-

qipëri, Gjykata e Krimeve të Rënda dha masën e sigurisë "Arrest me burg". Pasi qëndroi tre muaj në burg në Turqi, Kanani u lirua për mungesë provash dhe prej atëherë mendohet se udhëtoi në drejtim të Shqipërisë,

ndërsa dyshohet se ka kaluar kufirin ilegalisht. Burime jozyrtare pohuan se janë shoqëruar nga policia edhe dy persona të tjerë, pjesëtarë të të njëjtit grup kriminal, që merrej me trafikim e drogave të forta.

SHKURT

**I gjenden kokainë dhe hashash, pranga 27-vjeçarit**

**FIER** - Policia e Fierit dhe FNSH kanë ushtruar kontrolle në disa lokale, ndërsa kanë sekuestruar 33 doza kokainë, kanabis dhe një armë të ftohtë. Gjatë operacionit të koduar "Porosia e fundit" u arrestua në flagrancë 27-vjeçari Edi Subashi, banues në këtë qytet. Gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin e tij tip "Ford", në çantën e shpinës iu gjetën 8 doza me kokainë. Ndërsa, gjatë kontrollit të banesës ju gjetën edhe 25 doza të tjera të kokainë dhe disa doza kanabis. Në cilësinë e provës materiale, të riut iu sekuestrua lënda narkotike, një peshore elektronike, e cila shërbente për ndarjen lëndës narkotike në doza, automjeti autoveturë, tre aparate celularë, 450 euro dhe 470 mijë lekë. Ndërkohë, materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

**Plagoset rëndë në aksident 11-vjeçari, shoqërohet shoferi**

**FIER** - Një aksident ka ndodhur pasditen e djeshme në periferi të Fierit, ku ka mbetur i plagosur një fëmijë. Sipas burimeve policore, ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:10, në rrugën Fier-Seman, në fshatin Fermë Çlirim. Mësohet se shtetasi A.X.H., 33 vjeç, banues në Seman, duke drejtuar mjetin tip "Skoda", ka aksidentuar 11-vjeçarin me iniciale M.G., banues në fshatin Dërmenas Fier, të cilin e ka shoqëruar në Spitalin Rajonal Fier. I mituri u dërgua në Spitalin e Traumës në Tiranë për mjekim më të specializuar. Ndërsa, drejtuesi i mjetit u shoqërua në Komisarjatin e Policisë Fier. Grupi hetimor po punon intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.

**24-vjeçari që vrau 8 persona braktiset nga familjarët**

## Masakra e Selenicës në Vlorë, ekzekutori Ritvan Zykaj një muaj i vetëm në qeli


**VLORE** - Një muaj pasi masakroi me automatik 8 të afërmit e tij në fshatin Resulaj të Selenicës, 24-vjeçari Ritvan Zykaj është më i vetmuar se kurrë. Jo vetëm faktin që është vendosur të qëndrojë vetëm në qelinë e paraburgimit të Vlorës, por edhe sepse pas kryerjes së krimin, asnjë prej familjarëve nuk e ka vizituar. Mësohet se i riu qëndron i vetëm në dhomë dhe e vetmja gjë që bën shumicën e ditës, mban në duar libra të sugjeruara nga psikologët. Nuk dihet nëse i lexon, por një ditë, kur një anëtar i

**NGJARJA**

Më 10 gusht të këtij viti, 8 persona, pjesëtarë të dy familjeve të të njëjtit fis u vranë sa hap e mbyll sytë në fshatin Resulaj të Selenicës në Vlorë. Pas ngjarjes së rëndë, policia bëri me dije se 24-vjeçari Ritvan Zykaj, i cili dyshohet se vuan nga probleme mendore qëlloni me breshëri automatik të afërmit e tij (kushërinj të parë të babait), ndërsa ka përdorur thujtase 2 karikatorë.

stafit ka hyrë në qeli, ka parë Ritvanin që e mbante librin mbrapsht. Ritvani ha ushqimin e burgut, sepse autoritetet nuk lejojnë që atij t'i vijin ushqime nga jashtë për arsye sigurie. Në asnjë

moment nuk e ka refuzuar, duke e ngrënë të gjithë sasinë që i është ofruar dhe pa bërë kurrë ndonjë kërkesë specifike. Nga ana tjetër, as familjarët nuk kanë shfaqur dëshirën për t'i sjellë ushqime



Ritvan Zykaj

shtëpie, siç ndodh me të dënuarit apo të paraburgosurit e tjerë. I vetmi rast kur një i afërm vizitoi 24-vjeçarin, ishte kur i dërgoi disa veshje të nevojshme dhe që atëherë, askush nuk është interesuar për të. Sipas burimeve nga paraburgimi i Vlorës, Ritvan Zykaj nuk ka treguar ndonjë pendesë për krimin e kryer. Madje, diku është shprehur se do

ta vriste sërish në çdo rrethanë, një prej grave që vrau ditën e masakrës. Teksa pritet të kryhet ekspertimi mendor, Ritvan Zykaj mbahet i izoluar për të siguruar jetën e tij, pasi përvoja ka treguar se të paraburgosurit ose të dënuarit e tjerë mund të ndëshkojnë në mënyrën e tyre një autor krimi, kur ky i fundit ka vrarë fëmijë ose gra.



**TIRANE** - Gjykata e Krimeve të Rënda vijon procesin ndaj 54-vjeçarit Fadil Kasemi, i cili një vit më parë vrau me armë zjarri ish-bashkëshorten e tij gjyqtare, Fildes Hafizin. Gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar ditën e djeshme kanë dëshmuar dy policët Nazmi Kosta dhe Dashnor Murataj, të cilët ishin personat e parë që ranë në kontakt me 54-vjeçarin, pak pasi ky i fundit ekzekutoi gjyqtaren. Gjatë dëshmisë së dhënë, efektivet treguan detaje nga dita kur ndodhi ngjarja, ndërsa rrëfyen se kishin parë një person të armatosur në oborrin e komisarariatit nr.1, ku në një njerëz dorë mbante pistoletë dhe

**Zbardhet ngjarja, ja çfarë deklaroi ditën e atentatit 54-vjeçari**

**Vrau ish-gruan, policët dëshmojnë në gjyqin ndaj Fadil Kasemit**

**DËSHMITË**

"Kam vranë një njeri, kam ardhur të dorëzohem", mësohet të ketë thënë Kasemi pasi është paraqitur në komisarariat. "Pasi i morëm armën, Kasemi tha që kishte vranë Fildes Hafizin tek 'Xhamlliku", thanë policët dëshmitarë.

në tjetrin krehrin. "Kam vranë një njeri, kam ardhur të dorëzohem", mësohet të ketë thënë Kasemi pasi është paraqitur në komisarariat. "Pasi i morëm armën,

Kasemi tha që kishte vranë Fildes Hafizin te 'Xhamlliku", thanë policët dëshmitarë. Në seancën e datës 6 shtator, mbrojtja ka kërkuar riekspertimin e gjendjes

psikike të Kasemit, pasi sipas tyre ka qenë i shtruar në spital. Avokati i tij, Ilia Ilia, kërkoj gjykim të shkurtuar për klientin e tij, ndërsa gjykata e rrëzoi. Fildes Hafizi u ekzekutua nga ish-bashkëshorti i saj, Fadil Kasemi, më 31 gusht të vitit të kaluar, pranë shtëpisë ku banonte në Tiranë, në zonën e "Xhamllikut". Ngjarja erdhi pas shumë vitesh konfliktesh, për të cilat çifti edhe ishte divorcuar. Madje,



Gjyqtarja Fildes Hafizi

gjyqtarja ishte kanosur nga Kasemi vazhdimisht, duke kujtuar këtu ngjarjen te "Shkëmbi i Kavajës", ku 54-vjeçari ishte edhe i armatosur. Gjyqtarja kishte kërkuar edhe transferim në Tiranë, por KLD e kishte vendosur në Shkodër, rrethin

më të largët që ajo kishte kërkuar, pasi ndihej e kërcënuar nga ish-bashkëshorti. Fadil Kasemi akuzohet për kryerjen e veprave penale të "vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare", "armëmbajtje pa leje" dhe "rëmbim personi".

Mori 80 mijë euro për të kryer krimin, u dënua në mungesë me 20 vite burg

**Tentoi të vrasë Lulzim Berishën, rihapet çështja për Ahmet Ajetin**

**35-vjeçari kosovar fiton të drejtën e rigjyimit**

**VENDIMI**

Dy muaj pas ekstradimit nga Lipjani, 35-vjeçari kosovar fitoi të drejtën e rigjyimit. Në vendimin e firmosur tri ditë më parë nga gjykatësi Klodian Kurushi, thuhet se i pandehuri nuk ka marrë asnjëherë dënimin për çështjen dhe interesat e tij janë mbrojtur nga një avokat i caktuar nga shteti dhe jo i zgjedhur prej tij.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka rihapur ditën e djeshme çështjen për 35-vjeçarin Ahmet Ajeti, i cili në vitin 2005 tentoi të vrasë Lulzim Berishën. I dënua në mungesë me 20 vjet burg për tentativë vrasjeje, Ajeti kërkoj rishqyrtimin e dosjes në prani të tij. Kërkesa u aprovua me argumentin se ai është gjykuar në mungesë, pa pasur dijeni për procesin që është zhvilluar në të gjitha shkallët e gjyqësorit në vend. Dy muaj pas ekstradimit nga Lipjani, 35-vjeçari kosovar fitoi të drejtën e rigjyimit. Në vendimin e firmosur tri ditë më parë nga gjykatësi Klodian Kurushi thuhet se i pandehuri nuk ka marrë asnjëherë dënimin për çështjen dhe interesat e tij janë mbrojtur nga një avokat i caktuar nga shteti dhe jo i zgjedhur prej tij. Për rrjedhojë, nuk ka pasur mundësi të paraqesë prova apo të sqarojë pozicionin e tij në ngjarje dhe për këto arsye gjykata ka vendosur t'i japë mundësinë që të përballet me një trupë gjyqësore. Sipas hetimeve të 13 viteve më parë, Ahmet Ajeti dhe Osman Karpuzi u porositën nga Adriatik Çoli dhe Endrit Dokle për të eliminuar Lulzim Berishën, kreun e bandës rivale në qytetin e Durrësit. Gjatë procesit të mëparshëm gjyqësor, i penduari i bandës, Adriatik Çoli deklaroi se Ajeti u pagua 80 mijë euro nga kundërshtarët e Lulzim Berishës për ta eliminuar atë.



Lulzim Berisha

kishin lindur midis anëtarëve, dikur të së njëjtës bandë, kanë kontaktuar dhe më pas kanë lidhur marrëveshje me dy shtetas kosovarë, me Osman Korpuzin e Ahmet Ajetin. Rezulton se këta persona janë takuar në Tiranë dhe u janë treguar të dhëna për të gjykuarin Lulzim Berisha dhe lëvizjet e tij dhe ata marrin përsipër që ta qëllojnë të gjykuarin Lulzim Berisha me armë zjarri të llojit pistoletë. Më pas të Korpuzi dhe Ajeti, të shoqëruar nga Sardinian Sulejmani, janë dërguar në qytetin e Durrësit dhe janë sistemuar në hotelin e Asto Hanxharit. Rezulton se pas sistemimit të tyre në këtë hotel, të gjykuarve Osman

Korpuzi e Ahmet Ajeti u janë dhënë dy armë zjarri, tip pistoletë me silenciator, njëra tip "Zastava" dhe tjetra tip "Uzi". Provohet gjithashtu se të gjykuarve Osman Korpuzi e Ahmet Ajeti u është dhënë edhe një fotografi e të pandehurit Lulzim Berisha. Në datën 30.08.2005, rreth mesditës, të gjykuarit Osman Korpuzi e Ahmet Ajeti janë nisur të armatosur në drejtim të lokalit ku qëndronte zakonisht i gjykuari Lulzim Berisha, me qëllim vrasjen e tij. Së bashku me ta ka qenë edhe Sardinian Sulejmani, i cili kishte për detyrë të kujdesej për ta derisa të realizonin vrasjen e Lulzim Berishës. Por, në afërsi të lokalit të sh-

tetasi Lulzim Berisha, në rrethana jo shumë të qarta, Ahmet Ajeti ka mbetur i plagosur. Rezulton se ai ka qenë paksa më i veçar nga dy të tjerët dhe se në një bar-bufe ka bërë një sherr banal, është grindur dhe në përpjekje për të nxjerrë armën e ka shkrepuar pa dashje atë, duke plagosur veten. Ai ka qëlluar edhe një herë në ajër. Në ndihmë të tij kanë shkuar Osman Korpuzi e Sardinian Sulejmani, të cilët i kanë marrë pistoletën. Në vijim Sardinian Sulejmani i ka marrë Osman Korpuzit të dyja armët e zjarrit dhe është larguar, ndërsa i gjykuarit Osman Korpuzi ka njoftuar policët e qarkullimit rrugor që po kalonin rastësisht në rrugë, me qëllim që t'i vinin në ndihmë shokut të tij Ahmet Ajeti, i cili vazhdonte të ishte i plagosur në hyrjen e një pallati. Ahmet Ajeti është shoqëruar për në spitalin rajonal Durrës dhe nga marrja në pyetje e tij si dhe e Osman Korpuzit nga ana e policisë gjyqësore, e cila filloi menjëherë veprimet hetimore për ngjarjen, nuk është treguar qëllimi i vërtetë i ardhjen së tyre nga Kosova, duke u justifikuar me arsyen e pushimeve në plazhin e Durrësit. Ndaj dy shtetasve kosovarë është ushtruar kontroll fizik nga ana e policisë gjyqësore, prej nga ka rezultuar se tyre portofolin e njërit prej tyre është gjendur një fotografi e të gjykuarit Lulzim Berisha e mbështjellë, e cila së bashku me celularin i janë sekuestruar.

**SHKURTE**

**Ekzekutoi prindërit e tij, Mirald Metallari kërkon gjykim të shkurtuar**

**BATHORE** - Kur ka kaluar rreth një vit nga ngjarja e rëndë në Bathore, ku Mirald Metallari ekzekutoi nënën dhe babain e tij polic me armën e shërbimit, 21-vjeçari kërkon gjykim të shkurtuar. Kërkesë kjo, e cila është rrëzuar nga gjykata. Ngjarja ka ndodhur më datë 24 korrik 2017 në Bathore, teksa Mirald Metallari, 21 vjeç, për shkak të një konflikti të çastit, teksa ndërtonin një mur betoni në oborrin e shtëpisë u konfliktua me të atin punonjës policie dhe më pas e qëlloi atë duke e lënë të vdekur në vend. Për të ndaluar aktin e rëndë në mes hyri dhe nëna e Miraldit, Nurie Metallari, 47 vjeçe. Ajo mbeti e plagosur, por nuk mundi t'u mbijetojë plagëve të marra dhe ndërroi jetë në spital. "Më datë 24.07.2017, rreth orës 11:20, në numrin e Emergjencave 112, ka ardhur një telefonatë për të shtëna me armë zjarri në Bathore. Në vendngjarje kanë mbërritur shërbimet e policisë dhe ambulanca.

**Vetingu, Gjykata e Lartë shpall zyrtarisht listën e kandidatëve për anëtarë të KLGJ**

**TIRANE** - Gjykata e Lartë e ka shpallur dje zyrtarisht listën e kandidatëve për anëtarë të Kolegjit të Lartë Gjyqësor. Pas rishpalljes së thirrjes javën e kaluar, paraqitën kandidatë gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Brikena Ukperaj dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Luan Dervishi. Pas përfundimit të procesit të verifikimit të plotësimin të kushteve ligjore, rezultoi se të dy kandidatët i plotësonin kushtet ligjore për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, raporton gazetari Arsen Rusta. Kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë: Nga Gjykata e Lartë, Medi Bici. Nga Gjykatat e Apeleve Ilir Toska - Gjykata e Apelit Tiranë; Nertina Kosova - Gjykata e Apelit për Krime të Rënda; Luan Dervishi - Gjykata e Apelit Shkodër (nuk ka kaluar në veting); Brikena Ukperaj - Gjykata e Apelit Vlorë. Nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore: Alma Brati - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Astrit Faqollari - Gjykata e Gjyqësor Rrethit Tiranë (çështja në KPA); Brunilda Kadi - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Manjola Xhaxho - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Marçela Shehu - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë pritet të jenë dy organe shumë të rëndësishme të zbatimit të reformës në drejtësi dhe roli i tyre është i përcaktuar specifikisht.

Më 17 shtator nis regjistrimi i banesave, procedura që duhet ndjekur

# Lame: Ja tri dokumentet që duhet të dorëzoni pranë ALUIZNI-t

## Ndërtimet para vitit 1991, përfitojnë 60 mijë pronarë



Ahmetaj, letër autoritetit mbikëqyrës: Largoni kumarin!

Ministri i Financave, Arben Ahmetaj i ka kërkuar zyrtarisht Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit që të nisë punën për zhvendosjen e kazinove jashtë zonave të banuara. Ligji për lojërat e fatit parashikon se brenda datës 31 dhjetor 2018, të gjitha kazinotë elektronike duhet të zhvendosen jashtë qendrave të banuara, ndërsa pikat e basteve duhet të kenë një distancë minimale 100 metra nga institucionet fetare dhe shkollat. Përmes një shkresë zyrtare, kreu i Financave ka ngarkuar Autoritetin që të mbikëqyrë zbatimin e këtij detyrimi. "Duke pasur në konsideratë sensibilitetin e këtij procesi dhe rëndësinë e zbatimit me sukses të tij, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit të ndjekë e të mbikëqyrë me intësi procesin, me qëllim respektimin me rigorozitet të kërkesave dhe afateve ligjore", shkruan në letër Ahmetaj. Përveç mbikëqyrjes, Autoriteti do të jetë i detyruar që të raportojë çdo javë për numrin e subjekteve që zhvendosen. "Në zbatim të detyrimeve ligjore, të merren të gjitha masat për përmbushjen e detyrimeve nga subjektet e Lojërave të Fatit dhe të raportohet në terma javorë mbi ecurinë e procesit", shkruan më tej Ahmetaj.

Ornela Manjani

Ditën e hënë të gjithë qytetarët që kanë në pronësi një objekt të ndërtuar përpara vitit 1991, por nuk disponojnë hipotekën, mund të shkojnë e të nisnin procedurat për marrjen e saj. Çdokush mund të nisë aplikimin në zyrat rajonale të ALUIZNI-t dhe të sjellë dokumentacion që provon pronësinë: leje ndërtimi të vjetra, akte pronësie, skica dhe gjenplane apo vendime të vjetra të Këshillave Popullore. Çelja e procedurës u bë e ditur nga kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame. "Kjo është sfida e ardhshme e qeverisë. Duke nisur nga 17 shtatori, të gjithë ata që nuk kanë dokument pronësie për banesat para vitit '91, duhet të paraqiten në sportelet tona për aplikim. Të mbledhin çdo dokument që kanë në lidhje me shtëpitë e tyre të përgjithshme. Kjo nuk është e detyrueshme, por çdo dokument që mund të keni ndihmë institucionin për dosjen. Formulari i aplikimit mund të shkarkohet edhe në faqen e internetit të ALUIZNI-t", shpjegoi Lame. "Meqenëse kemi të bëjmë me një problem që prek mijëra familje, do të kërkoja mirëkuptimin e qytetarëve që të mos krijojnë radhë. Të paraqiten fillimisht ata që e kanë të domosdoshme dokumentacionin e pronësisë: ata që duan ta shesin shtëpinë, ata që duan të marrin kredit, ose ata që janë për shpronësim, sepse u kalon rruga që shtëpia", u shpreh Lame.

### VENDIMI PARASHIKON

- Lehtësimin e barrës së aplikuesit nga detyrimet dhe dokumentacioni i tepërt, (aplikuesi tanimë do të duhet të paraqesë vetëm një numër shumë të kufizuar dokumentesh pranë ALUIZNI-t).
- Zgjidhja e të gjithë pamundësisë së deritanishme, për të provuar periudhën e ndërtimit (para datës 10.8.1991), gjë që ka penguar finalizimin e procedurës.
- Kalimi i pronësisë së truallit të ndërtesës falas deri në 300 metra katrorë, si dhe mundësia për të blerë sipërfaqet mbi këtë masë.

ca gjenplane, akte shitblerjeje apo posedimi, vendime të vjetra të Këshillave Popullore, apo dokumente të tjera provuese të çdo lloji dhe kohe. Formularët e aplikimit mund të plotësohen pranë Drejtorive Rajonale në të gjithë Shqipërinë. Meqenëse kemi të bëjmë me një problem të mbaritur prej dhjetëra vjetësh dhe që intereson me dhjetëra mijëra familje, do të kërkoja mirëkuptimin e qytetarëve për të mos krijuar situata radhësh dhe grumbullimesh pranë sporteleve tona. Në një periudhë të parë, le të paraqiten ata qytetarë që kanë urgjencën të ndryshme, duan të shesin banesën, çështje kryesh, trashëgimie etj., si dhe ata qytetarë që e kanë filluar këtë aplikim pranë bashkive. Më pas, le të vazhdojmë qetësisht së bashku me qytetarët e tjerë. Në këto vite krijuam besim të qytetarët dhe çuam drejt përfundimit kalvarin e legalizimeve. Me të njëjtin besim u drejtohem qytetarëve, që edhe këtë sfidë të re ta përballojmë së bashku", - tha Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame.

### VENDIMI

"Në korrik 2018, qeveria miratoi Vendimin 442: 'Për regjistrimin e banesave të ndërtuara para vitit 1991. Ky Vendim i Këshillit të Ministrave shërben si bazë ligjore për dhënie të dokumentit të pronësisë pronarëve të banesave të ndërtuara para vitit 1991, në të gjitha ato raste kur ky dokument mungon. Pra, qëllimi i këtij vendimi është të formalizojë një kategori pasurish të paluajtitshme, të cilat edhe pse fizikisht ekzistojnë dhe zotërohen prej dekadash (herë-herë edhe prej shekujsh), pronarët e tyre nuk

kanë pasur dokumentacion të mirëfilltë pronësie, duke mos i gëzuar asnjëherë ligjërisht. Numri i banesave që mendohet të trajtohen nga ky vendim është 40-60 mijë. Duhet theksuar se asnjëherë nuk është bërë një evidencim i plotë dhe i saktë i këtyre objekteve, ndaj si rrjedhim, shifra reale mund të jetë edhe më e lartë se ajo e mësipërme", - tha Lame. Sipas tij, zbatimin e këtij vendimi dhe të gjithë procedurës përkatëse, qeveria ia ngarkoi ALUIZNI-t. Tashmë që procesi i legalizimeve ka hyrë në fazën përmbyllëse të tij, procesi i regjistrimit të banesave para vitit 1991 është sfida e radhës e ALUIZNI-t. "Risiti kryesorë të vendimit miratuar së fundmi janë: 1. Lehtësimi i barrës së aplikuesit nga detyrimet dhe dokumentacioni i tepërt, (aplikuesi tanimë do të duhet të paraqesë vetëm një numër shumë të kufizuar dokumentesh pranë ALUIZNI-t). 2. Zgjidhja e të gjithë pamundësisë së deritanishme për të provuar periudhën e ndërtimit (para datës 10.8.1991), gjë që ka penguar finalizimin e procedurës. 3. Kalimi i pronësisë së truallit të ndërtesës falas deri në 300 metra katrorë, si dhe mundësia për të blerë sipërfaqet mbi këtë masë.

## Instat, shitjet me pakicë Rritje 2.4%, por e "fryrë" nga karburantet

Shitjet me pakicë u rritën me një ritëm më të lartë në tremujorin e dytë të vitit. Sipas Institutit të Statistikave, indeksi i shitjeve në tregtinë me pakicë u rrit 2.4% me bazë vjetore. Kjo është rritja më e lartë e shitjeve me pakicë në ekonomi që nga fillimi i vitit 2017. Megjithatë, një ndikim të konsiderueshëm në ecurinë e shitjeve me pakicë do vazhdon të ketë tregtia e karburanteve. INSTAT raporton se po të përjashtojmë tregtinë e hidrokarbureve, rritja e shitjeve me pakicë do të ishte e përgjysmuar, me 1.2%. Ndaj, po të përjashtojmë karburantet, rritja e shitjeve me pakicë në ekonomi nëqellet ende shumë modeste. Shitjet me të lartë të këtij komponenti në rritjen ekonomike. Konsumi është shtylla kryesore e rritjes së ekonomisë shqiptare, me mbi 80% të kontributit total. Në tremujorin e dytë rritja e shitjeve ishte më e ekuilibruar mes produkteve ushqimore dhe joushqimore. Përkatësisht, shitjet e produkteve ushqimore u rritën me 1.4%, ndërsa ato joushqimore me 1.2%. Në parim, rritja e shitjeve në mënyrë lineare, pavarësisht elasticitetit të kërkesës, mund të interpretohet si zhvillim pozitiv.

## Kina, investitor potencial Shkëmbimet tregtare mes dy vendeve 4 mld dollarë, synohet rritje e tyre

Rreth 4 miliardë dollarë është vlera e shkëmbimeve tregtare mes Kinës dhe Shqipërisë deri në muajin korrik. Por, kjo vlerë financiare është vlerësuar si e pamjaftueshme për potencialin që kanë të dyja vendet. Gjatë një prezantimi të investitorëve potencialë nga provinca e Anhuit, drejtori i byrosë tregtare, Zhan Jian u shpreh se duhet të mbrohen investimet e huaja, në mënyrë që të rriten shkëmbimet tregtare mes dy vendeve. Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato e ka cilësuar Kinën si partnerin e tretë të Shqipërisë në ekonomi. Por sipas saj, potenciali i bashkëpunimit është i madh në fushën e bujqësisë, infrastrukturës, energjisë së rinovueshme dhe veshjeve. Aktualisht, investimet kineze në vendin tonë janë në vlerën e 700 milionë dollarë. Ndërkohë që provinca e Anhuit-t është e rikthyer shifrenë prej 53 miliardë dollarësh, prej të cilave 5.4 milionë dollarë i ka me Shqipërinë. Kjo shiferë përbën vetëm një për qind të të gjithë vullmit të eksporteve që ka me botën. Në kuadrin e rritjeve të shkëmbimeve tregtare u zhvillua edhe takimi me kompanitë me potencial investimi të kësaj provincë me ato shqiptare.



Lista e plotë/ Ja kur duhet të paraqiteni pranë KMCAP

# KEMP-i, zbardhen emrat e 308 personave që do të kryejnë kontrollet mjekësore

Voltiza Duro

Instituti i Sigurimeve Shogjore ka zbardhur emrat e personave që do t'u nënshtrohen kontrolleve mjekësore në KMCAP Epror gjatë muajit shtator për të marrë pensionin. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e plotë me emrat e 308 personave që duhet të kryejnë ekzaminimet brenda muajit pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Afësisë për Punë. Këta individë, në rastin që nuk do t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor, nuk do të mund të marrin apo rimarrin pensionin e invaliditetit nga ISSH. Të gjithë ata persona që

bëhen të paafetë për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjytime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Për të përfutur këtë lloj pensioni të plotë, të reduktuar dhe të pjesshëm, përfutuesi ose i autorizuari me prokurë paraqitet në ALSSH të vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfutimit të pensionit të invaliditetit. Përfutuesi për pension invaliditeti ose i autorizuari me prokurë, së bashku me kërkesën duhet të paraqesë dhe dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin, ato që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe doku-

mentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara e gjendjen shëndetësore. Ky dokumentacion i dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit, njofton datën për të kaluar në KMCAP ose i kthen mbrapsht dokumentet për pasaktësi. KMCAP në mbledhjen e tij shqyrton paraprakisht dokumentet, njofton dhe ekzaminon të sëmurin, merr vendimin përkatës jo në prani të tij dhe kryetari i KMCAP-it ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gojarisht dhe nëpërmjet vërtetimit. Kundër këtij vendimi, i sëmurë ose invalidi mund të ankohe tek KMCAP-i epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH përkatëse.

## LISTA E PERSONAVE QË DO TË PARAQITEN NË KMCAP EPROR PËR MUAJIN SHTATOR 2018

Nr.	Emër	Mbiemër	KMCAP	Data	Ora	Rrethi
<b>KARDIOLOGJI</b>						
1	VASIL	KAÇANINI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SARANDE
2	BAJRAM	SHUAIPI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SARANDE
3	DHIQLETE	SHEHU	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	GJIROKASTER
4	QEMAL	HALILA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	GJIROKASTER
5	AGIM	VARFI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	GJIROKASTER
6	MJAFTONI	HYSA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	GJIROKASTER
7	INAJET	ÇANI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	GJIROKASTER
8	ANDON	JANI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	GJIROKASTER
9	VELI	VELIU	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	DIBER
10	SELMAN	KATA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	DIBER
11	BAJRAM	HERA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	DIBER
12	NAZMIJE	THAÇI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KUKES
13	ADRIAN	EMINI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
14	VIKTOR	TEROLLI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
15	ELIVERTA	STORRA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
16	TRENDIAFILI	METE	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
17	MIRELA	MURIZI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
18	ADEM	MYFTARAGA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
19	KRISTO	KARAMETA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
20	KIMET	HASE	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
21	FLORENC	TOPALLI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
22	RAJMONDA	HOXHA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
23	KRISTO	QOSE	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
24	PAQESOR	KASOLLI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	KORÇE
25	LINE	SHAHINAJ	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
26	BAJRIJE	HADRAJ	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
27	NDUE	PECI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
28	PASHUK	LLESHI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
29	GJON	GURI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
30	AGIM	ÇELEPIJA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
31	DRITA	HOXHA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
32	BERHAN	BARANI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
33	LEONARD	GJERGJI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
34	ARTUR	VOCA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
35	NIKOLINA	HILA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
36	NDOC	MARKU	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	SHKODER
37	KASTRIOT	RESULAJ	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	VLORE
38	BESNIK	NUREDINI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	VLORE
39	BESNIK	SERDARI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	BERAT
40	HARTUR	SYLYKU	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	BERAT
41	NATASHA	PUTRO	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	BERAT
42	JANI	ÇERRA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	BERAT
43	VASILLAQ	PETO	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	FIER
44	TODI	TAJANA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	FIER
45	SAZAN	KORÇARI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	FIER
46	BARDHYL	GEGA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	FIER
47	KOLE	FIZI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	LEZHE
48	DED	ALIA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	LEZHE
49	ALBERT	MURATI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	ELBASAN
50	AGRON	LUFTA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	ELBASAN
51	NIKO	MIRAKA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	ELBASAN
52	LUAN	HOXHA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	ELBASAN
53	YMER	MUSTA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	ELBASAN
54	SABA	DURMA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	DURRES
55	ISMAIL	KEPI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	DURRES
56	KLIMA	MANI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
57	ISMAIL	MERKJA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
58	HARUN	TAFXHAFI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
59	LULEZIM	HOXHA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
60	XHELADIN	DEDA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
61	MARK	MULAJ	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
62	DHIMITER	LLAZARI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
63	AGIM	BALLA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
64	ELMAZ	SHEHI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
65	ARBEN	MANKA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
66	REXHEP	ZIZA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
67	MERITA	HYSKA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
68	PETRIT	NEZAJ	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
69	ADNAN	XHEMALÇE	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
70	MAKSIM	SHKEMBI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
71	ELIDA	BALLANCA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
72	AVNI	DUSHA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
73	HATIJE	ÇUKA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
74	HAJRIJE	LOKJA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
75	BESIM	DEDJA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
76	RAMIZ	LIMANI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
77	BRIKENA	AFEZOLLI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
78	DASHAMIR	SADIKU	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
79	GENTIAN	BOGDANI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
80	ARJAN	DOMI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
81	FEJZO	ELEZAJ	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
82	SHABAN	BASTANI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
83	SUZANA	SHKOZA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
84	BUJAR	GJONDEDAJ	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
85	LULZIM	BROJKA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
86	LULZIM	GJOKA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
87	ARJAN	HAKA	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
88	GENC	MECINI	KARDIOLOGJI	12.09.2018	08,00	TIRANE
<b>NEUROLOGJI</b>						
89	MUSA	PULA	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	GJIROKASTER
90	GEZIM	HETA	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	DIBER
91	MIRANDA	KUKA	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	DIBER
92	ZELFIJE	HAJRI	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	DIBER
93	NAIM	HYSA	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	DIBER
94	SABRI	DARDHA	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	DIBER
95	HASUE	BAJRAMI	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	DIBER
96	NEXHMIJE	HASA	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	DIBER
97	YLBER	KURTAJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	DIBER
98	FADIL	MULLA	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	KORÇE
99	VASFI	ÇUÇKA	NEUROLOGJI	19.09.2018	08,00	KORÇE
100	NIKOLIN	PRENDI	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
101	PAL	KOLA	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
102	FEJZULLA	GJYLBEGAJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
103	LENE	GJERGJI	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
104	VIOLLCA	JAHJA	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
105	SULLTANE	XHAFAJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
106	BESNIK	ÇOKU	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
107	MIRE	SELVIA	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
108	TOM	DANGU	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
109	GYSTINA	LAMI	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
110	BILAL	DUSHI	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
111	MILAZIM	CENAJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
112	AFERDITA	ÇEREÇI	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
113	KUIE	HALAJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
114	ROZE	GEGA	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
115	NORE	DIZDARI	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
116	ZUA	LEFTHIJA	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
117	FISNIK	KOPLIKU	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
118	AGE	PALI	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
119	GJOVALIN	NDOU	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
120	FIQIRETE	SYKAJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	09,00	SHKODER
121	BARDHOK	GJOKA	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	LEZHE
122	VALENTINA	MARNOJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	LEZHE
123	SOSE	KOLNDREU	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	LEZHE
124	PASHUK	KACOLI	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	LEZHE
125	VAGO	BAJRAMI	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	VLORE
126	LAVDURIM	DUSHAJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	VLORE
127	VANGJEL	CANIA	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	BERAT
128	VASIL	JOVANI	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	FIER
129	MIMOZA	SILA	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	FIER
130	FESTIM	AVDIAJ	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	FIER
131	RAZUE	HOXHOLLI	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	ELBASAN
132	KADRI	DOSKU	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	ELBASAN
133	BAJRAM	BUKU	NEUROLOGJI	19.09.2018	10,00	ELBASAN

(vijon)

## SPECIALE

## DËNIMI I KADRI HAZBIUT, FEÇOR SHEHUT ETJ.

Ekskluzive / Dokumenti tepër sekret i sekretarit të parë të Korçës, Enver Halili, për Komitetin Qendror

# "Mehmeti dhe Mihallaq Ziçishti zvarritën arrestimin e agjentit grek, Tefik Cangoi"

## Raporti i Sigurimit: "Kadri Hazbiu mbuloi kontrabandën që bënte Gani Kodra me italianët në 1972-in"



Nga DASHNOR KALOÇI

Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolette në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe sot pas 37 vjetësh vazhdohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë, në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutoheshin: "nën frymën e fjalës së shokut Enver Hoxha, për armikun Mehmet Shehu", të cilat do t'i shërbenin më pas Enverit për të shkruar "Tablo sinoptike për poligjentin Mehmet Shehu"? Në të gjitha këto mbledhje, veç të tjerash, ashtu siç bëhet e ditur edhe nga një mori dokumentesh me siglën "Tepër sekret", që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, pjesëmarrës e diskutantë të shumtë që kanë marrë fjalën aty, kanë hedhur llojlloj akuzash, me të vërteta dhe të pavërteta, denoncime, spjetime, shpifje, trillime, thashetheme, intriga, sajesa e gjithfarë u kanë ardhur për shtat, të gjitha këto në drejtim të kundër ish-kryeministrit të vdekur, Mehmet Shehu,



familjes së tij dhe atyre që u konsideruan bashkëpunëtorë të tyre, duke përmendur me dhjetëra emra, ushtarakë, funksionarë të lartë, etj. etj. Po kështu, këto mbledhje u intensifikuan së tepërmi, sidomos pas tetorit të vitit 1982, kur u arrestua dhe Ministri i Mbrojtjes Kadri Hazbiu, (i cili për gati tre dekada me radhë kishte mbajtur postin delikat të Ministrisë së Brendshme), ku dhe ndaj tij, u përsërit e njëjta tablo, si me ish-kryeministrin Mehmet Shehu. Dhe pas zhvillimit të këtyre mbledhjeve, komitetet e partisë të rretheve përkatëse, kanë hartuar një sërë raportesh me përmbledhje nga "problemet më kryesore", të cilat më pas ia kanë dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së. Për të gjitha këto

mbledhje, "Gazeta Shqiptare" disponon një numër të madh dokumentesh të nxjerra nga një dosje voluminoze me siglën "Tepër sekret", ku ish-anëtarë të Byrosë Politike, sekretarë të Komitetit Qendror të asaj kohe, si Spiro Koleka, Enver Halili, Vangel Cerrava etj., informojnë Komitetin Qendror për mbledhjet ku kanë marrë pjesë, duke dhënë me detaje dhe hollësiira gjithçka është thënë dhe diskutuar aty. Po kështu përveç këtyre raportëve, në dosjen në fjalë, gjenden edhe një sërë raportesh të hartuara nga funksionarë të rangjeve më të ulta që nga Komiteti Qendror e më poshtë, apo dhe raportet kolegjiale të Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe, shtabeve, komandave dhe komiteteve të partisë së

Korpuseve ushtarake, që ishin edhe njësitë më të mëdha që kishte Ushtria shqiptare asokohe. Nga kjo dosje voluminoze që "Gazeta Shqiptare" e disponon të plotë, në dy numrat e kaluar publikuam raport-informacionin e ish-anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH-së, Spiro Koleka, dërguar Komitetit Qendror, lidhur me aktivin e partisë të rrethit të Pogradecit, ku ai ka marrë pjesë si i deleguar më 25 shtator të vitit 1982. Për të vazhduar nga ky numër e në vijim, (në tre shkrieme radhazi) me raport-informacionin "Tepër sekret" të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Korçës, Enver Halili, dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së (personalisht Enver Hoxhës) lidhur me punën dhe veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit në rrethin e Korçës si dhe "impalikimin" e Mehmet Shehut, Kadri Hazbiut, Feçor Shehut etj., me punonjës të Sigurimit dhe persona të tjerë në atë rreth dhe më gjere.

(vijon nga numri i kaluar)

PARTIA E PUNES E SHQIPERISE Tepër sekret KOMITETI I PARTISE RRETHIT

K o r ç ë Korçë, më 28.10.1982

INFORMACION Për

DISA PROBLEME QE DUALLEN NGA DISKUTIMI I KONKULZIONEVE TE BYROSE POLITIKE DHE TE PLENIUMIT TE 5-TE TE KQ TE PARTISE NE ORGANIZATAT BAZE TE PARTISE TE DEGES SE PUNEVE TE BRENDESHME DHE TE PROKURORI-GJYKATES

Për Feçor Shehutin:

-Në vitin 1979 në Lezhë ka dalë një e dhënë se në zonën e gjuetisë do të vinin diversantë, ai i ka thënë kryetarit të kësaj Dege se: "Në Lezhë nuk ka pasur banda as atëhere kur ata vinin me shumicë".

-Me veprimet që ka kryer në vitin 1954 në drejtim të bandës së Reshat Qemalit, duke mos vlerësuar të dhënat, për ardhjen e saj e duke marrë masa të dobta u vranë katër shokë.

Për Mihallaq Ziçishtin:

-Së bashku me Mehmet Shehun kanë kthyer 2-3 herë goditjen e Tefik Cangoi, i cili pas arrestimit u deshifrua agjent i zbulimit grek.

-Nuk i ka shkuar deri në fund procesit të Braçanit në vitin 1959-1960, i cili ishte në shërbim të zbulimit grek.

-Ka shkelur rregullat e regjimit kufitar duke gjuajtur në brez e zonë kufitare, bile me armë luftarake.

-Ka vajtur për darka dhe dreka në persona me biografi të keqe si në zonën e Lozhanit e gjetkë.

-Për Gjykatën e Lartë, e cila mban përgjegjësi edhe

për gjykimin e puçistëve si për studimin e dosjeve të tyre ashtu edhe për gjykimin e çështjes.

-Për Prokurorin e Përgjithshëm i cili duhet të ishte më parimor dhe më barrikadë, sepse në shumë raste ato janë pronicuar me mendimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për Bajram Nelin:

-Ka ardhur dhe ka gënduar 3-4 ditë në qytetin e Korçës me makinë në dispozicion në një familje me qëndrim jo të mirë moral, kryefamiljari i së cilës tani është në burg.

-Për Merdar Hasa, kryetar Dege në Gjirokastrë: Ka pasur shoqëri të sëmurë me Feçor Shehun e Bato Karafilin, vriste derra dhe ua çonte në shtëpi atyre. Ishte arrogant dhe prepotent deri edhe në organizatën bazë të partisë.

Veç sa thamë më sipër, komunistët ngritën edhe këto çështje:

-Për Gani Kodrën kanë dalë të dhëna që më 1972 e implikojnë atë në kontrabandë me italianët. Kadri Hazbiu ka thënë: "e pamë, por duhet të bëjmë përgjashitim".

-Më 1979 kishim të dhëna-vazhdon komunisti Bajram Sulejmani, për kulakët e Bregut të Matës, se janë lidhje e jugosllavëve, por Feçor Shehu na e hodhi poshtë dhe u mbyll kjo çështje.

-Komunisti Kasëm Skëndo, shifrant në Degë, tha:

Përbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të Tretë për pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq. 234, Z.K-1791, Apartamenti me Sip.-209.7 m<sup>2</sup>, në vlerën 4756'000 (Katër milion e shtatëqind e pesëqindë e gjashtë mijë) Lekë.  
- Pasuria Nr. 250/3+1-3, Vol.-31, fq. 235, Z.K-1791, Apartamenti me Sip.-209.7 m<sup>2</sup>, në vlerën 4756'000 (Katër milion e shtatëqind e pesëqindë e gjashtë mijë) Lekë.  
- Pasuria Nr. 211/1, Vol.-4, fq. 201, Z.K-1791, Iqj Arië me Sip.-500 m<sup>2</sup>, në vlerën 252'000 (Dyqind e pesëqindë e dy mijë) Lekë.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 03.10.2018, në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll-1/3, Kati 2, Tiranë. Cel. 069 73 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com

SHPALLJE ANKANDI

Date 18.09.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përbarimtare "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tirane. Tel. 40458424, Cel. 069 201 9460/068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e dytë për pasuritë e paluajtshme të dështuarit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzuesit Halilhe Shefqet Burhan:

"Apartamenti barimi + Trulli" me sipërfaqe 62 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 14/301, zona kadastrale 3574, regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 2561 datë 07.10.1994, adresa: Luga "15 Shtator", pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Tëpelenë.  
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 896 000 (tetëqind e nëntëqindë e gjashtë mijë) lekë.  
Ankandit do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimtare "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tirane.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERBARIMTARE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Pasuria nr. 26/ 319, e llojit 'trull', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;  
B. Pasuria nr. 26/ 320, e llojit 'trull', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;  
ÇMIMI 78.976.000 LEKË për secilin pasuri; në Total 157.952.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 26.09.2018.  
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .





“Në vitin 1977 jam thirrur nga Andon Deçka me porosi të Feçor Shehut dhe më është dhënë detyra të përpiloj një shërbim të veçantë dypse që nuk është përdorur deri më sot, të jetë e fortë, që mund të komunikojnë dy veta në gjuhën shqip, frengjisht, ose në një tjetër. Pasi e bëra dhe ata i vunë pseudonimin “Karadaku”, dhashë edhe shpjegimet, me urdhër të Feçor Shehut dhe të Bato Karafilit mua më transferuan në Korçë në kundërshtim me vendimin e marrë më parë në Komitetin e Partisë së Ministrisë. Për këtë më tha: “Ka porositur shoku Hysni Kapo se ti je kandidat partie”.

—Kiço Ventiku, i dënuar më 1976 me 25 vjet burg për veprimtari armiqësore ka thënë në dhomat e paraburgimit se: “Po të më jepet mundësia të takoj dhe

të bisedoj me Mehmet Shehun, ai do të më kuptojë mua”.

—Komunisti Bardhosh Mamçaj tha se: “Me urdhër të drejtuesve të Ministrisë kemi përjashtuar agjunkturën e përshtatshme dhe se ato kanë vënë rregull, ky është dhe sot që materialet për dyshim spionazhi kur nuk sqarohet gjatë PP (përpunimit paraprak) që është tre muaj, të asgjësohen”.

—Komunisti Nazmi Qerre-ti, tha se: “Kur arrestuam Janaq Fotom më 1969 në Kamenicë, ai na tha: “Juve shikoni njerzit tuaj se nuk janë në rregull, kur ne e informuam

në Ministri ata e morrën dhe e hetuan atje”.

**II. PROKURORI-GJYKATE**

Në Prokurori Gjykatë döllën këto probleme. Kontrolli i Prokurorit ndaj organeve të hetimit nuk i është përgjigjur në të gjitha rastet detyrave të ngarkuara nga Partia si kontrolli i ligjshmërisë. Ka pasur raste që nga shokët që punojnë në sektorin e Kontrollit dhe Hetimit gjatë kontrollit të dhomave të izolimit në disa raste janë konstatuar persona të lejuar të kontrollohet nga prokurori, me arsyetimin se ky i burgosur është sekret. Në këto raste nga ana e prokurorit nuk është insistuar për të parë se ky i paraburgosur është futur ose jo në dhomat e izolimit brenda rregullave ligjore, por është besuar në thënie të punonjësve të Degës së Punëve të Brendshme. Kështu është rasti në vitin 1975 kur u arrestua Pirro Naçi për shkruarjen e parullave armiqësore, prokurori nuk morri kontakt me të, mbasi nga ana e ish-zv/drejtorit të Sigurimit të Shtetit, Lirim Pëllumbi, u cua për hetim në Pogradec dhe prej andej e kthyer përsëri në Korçë, por prokurorit ju ndalua takimi me të dhe me disa të tjerë.

Më shumë duhej të kërkohej nga prokurori për verifikimin e pretendimeve të pandehurve dhe të mos kalohej me shpresë se ky “është armik”, pasi nga verifikimi i plotë që u është bërë thënieve të pandehurve në ndonjë rast nuk ka pasur veprimtari armiqësore për të cilën akuzohej, ndërsa akuzat mbështetjet në trillime e punëtorit operativ dhe bashkëpunëtorit që e kishte. Kështu në rastin e Koço Dish-nicës, i cili fillimisht është marrë në arrest për luajtje bixhozi, përfundimisht do të akuzohej për agjitacion e propagandë armiqësore. Nga



dëgjimi me kujdes i pretendimeve të pandehurve rezultoi se provat ishin të krijara dhe jo të dëguara siç pasqyroheshin në materialet e çështjes hetimore, përfundimisht i pandehuri u dërgua në gjyq vetëm me kundravajtjen e bixhozit.

Zvarritjet e çështjeve kanë ardhur edhe si rezultat i praktikës së gabuar që përdorim që ka të bëjë me provën e çështjes sidomos të krimet kundër shtetit, bën vetëm pas bisedës me kryetarin e Degës së Punëve të Brendshme. Kështu megjithëse hetuesi i ka mbaruar hetimet, çështja mbahet me arsyetimin se do të analizohet nga Kryetari i Degës, i cili urdhëron mbylljen ose vazhdimin e hetimit. Në këto raste kontrolli i prokurorit nuk ka qenë në shkallën e duhur dhe është pajtuar me këto zvarritjet dhe shpesh ka miratuar edhe zgjatjen e afatit për vazhdimin e hetimeve, ndërsa dosja në gjyq ka vajtur me provat e marra që në fillim të hetimeve.

Në ndonjë çështje për krime kundër shtetit, agjitacion e propagandë, ka pasur dëshmitarë të njëjtë, me personalitet jo të mirë, që më vonë janë dënuar për agjitacion e propagandë siç është rasti i Arqile Kites, këto veprimet duhet të kishin tërhequr vëmendjen e prokurorit dhe gjykatës.

Prokurorit i është kufizuar kontrolli ndaj dosjeve të gjykuara. Në kushtetutë prokurorit nuk i bëhet asnjëherë kufizimi në ushtrimin e kontrollit, ndërsa me orientim të Gjykatës së Lartë, gjykatat e rretheve e kanë kufizuar këtë të drejtë brenda afateve të caktuara 5-10 ditë. Caktimi i këtyre afatave është një kufizim dhe pengesë që i bëhet prokurorit për të shtruar të drejtën e kontrollit kur ta shohë të nevojshme. Kjo çështje u është thënë shokëve të Prokurorisë së Përgjithshme por nuk është gjetur zgjidhje.

U shpreh mendimi se sistemi i organizimit të ri gjyqësor (këshillat gjyqësorë), i lëshoi subjektivizmit dhe nuk është objektiv në dhënie të drejtësisë. Këshillat gjyqësorë që janë pranë

gjykatës së rrethit të mos jenë të varura nga Kryetari i Gjykatës së rrethit, por të krijohen më vete. Gjithashtu për ngarkimin e gjykatës për çështje që i heton dhe i gjykon vetë, i lëshoi akoma më shumë shteg subjektivizmit për shkak se gjyqtari që do fillon një çështje dhe do të kryej veprime me të do të zgjidhet dhe masën e sigurimit, e cila është me pasojat për pandehurin. Në këto raste gjyqtari është i investuar që të zgjidhet ashtu si e ka filluar dhe jo ndryshe.

U shfaq mendimi se organi i hetimit të jetë organ më vete, i shkëputur nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe drejtoria e Hetuesisë të varet direkt nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, me qëllim që të ruhet sa më shumë objektiviteti në hetimin e çështjeve dhe të mos shpërndahet përgjegjësia.

Politika e dënimit në disa raste nuk ka qenë e drejtë, ka pasur çështje që mund të ishin pushuar pa u dërguar në gjyq. Po ashtu ka pasur çështje penale për krime kundër shtetit të cilat me gjithë insistimin e gjykatës së duhej të akuzoheshin edhe për tradhëti ndaj atdheut, janë sjellë në gjyq të akuzuar për agjitacion e propagandë, siç ishte çështja e Koço Dhimës. Gjithashtu në çështjen e Haxhi Baçit, Jorgo Llafazanit dhe Xhevat Zezos, hetimet janë bërë të cekta dhe në dosje nuk është pasqyruar veprimtaria e plotë agjendurore e tyre.

Në disa raste punonjësit e Degës së Punëve të Brendshme nuk paraqiteshin në gjyq si dëshmitarë, ndonjëherë kanë qenë të tillë, me arsyetimin sipas orientimit të dhënë nga armiku Feçor Shehu dhe se duhet të ruhet personaliteti i tyre. Por kur është vënë në dijeni Komiteti i Partisë i rrethit nga gjykatat, ky problem është zgjidhur drejt. Punonjësit e organeve të hetimit ndruheshin shumë nga pajafësitë e dhëna nga gjykatat për faktin se këto çështje bëheshin problem tek ministri dhe ai të bënte gjëmen. Këto kanë influencuar për punë negative të hetimit, i cili një pjesë të çështjeve i ka pushuar për mungesë provash, ose një pjesë i ka dërguar në gjyq vetëm me insistimin e

prokurorit. Në organet e hetimit disa kundravajtje penale janë ndjekur vetëm me një dëshmitar dhe janë deklaruar fajtorë, pasi nga shokët e hetuesisë nuk u është thënë se kanë prova të veçanta dhe gjyqtari Kiço Treska është pajtuar me to. Po ashtu janë bërë gjyqe për 2-3 çështje me dëshmitarë të njëjtë.

Shokët e Prokurorisë nuk duhet të praninon disa veprime jo të drejta të Hetuesisë siç kanë qenë rastet për pushimin e çështjeve me subjekt persona të organeve të brendshme (polcisë) etj dhe nuk janë çuar në gjyq.

Në disa procese gjyqësore si dhe gjatë kontrollit të prokurorit shokët e prokurorisë e gjykatës nuk janë thelluar sa duhet për të nxjerrë problem që kanë të bëjnë edhe me veprimtari armiqësore. Nga hetimi i një çështje për tentativa arratisje dhe agjitacion e propagandë ka dalë se është implikuar edhe Vat Kola, djali i shokut Marash Kola, i cili ka edhe sjellje dhe paraqitje jo korrekte për shoqërinë tonë. Marashi duhet të reflektojë për fajet e veprimet e gabuara të djalit të tij dhe megjithëse është këshilluar dhe kritikuar nga Komiteti i Partisë së rrethit dhe i Degës, si dhe nga organizata bazë e Partisë, ay mban përgjegjësi të rëndë.

Nga armiku Feçor Shehu iu është dhënë urdhëri organizatës së hetimit për mos procedimin e O. Q., e motra e N. P., e cila ishte bashkëpunëtorë në një grup të organizuar për vjedhje të mëdha. Me kërkesën e prokurorit të rrethit në Komitetin e Partisë të rrethit dhe pranë Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj saj u filluan hetimet dhe në gjendje arresti edhe gjykata e deklaroi fajtor.

Duke e konsideruar diskutimin e bërë vetëm si fillim të punës së tyre, organizata-bazë e Partisë vuan si detyrë që të vazhdohet puna për të ndihmuar partinë në thellimin e kësaj veprimtari armiqësore, duke nxjerrë nga fakte të veçanta konkluzione të drejta, të rritim proporcioneve për edukimin ideopolitik me materialet e Partisë e mësimet e shokut Enver për të likuiduar pasojat e kësaj veprimtari në organin e punëve të brendshme, gjykatë dhe prokurori, duke rritur më tej forcën zbuluese dhe vigjëlencën revolucionare.

Këto ishin në mënyrë të përmbledur çështjet që u ngritën në Komitet dhe organizatat bazë të partisë në Degën e Punëve të Brendshme si dhe Prokurori-Gjykatë.

Të gjitha mbledhjet u ndoqën nga të deleguarit e Komitetit të Partisë të rrethit, shokë të Byrosë dhe sekretariatit të Komitetit të Partisë së rrethit.

SEKRETARI I PARE I KOMITETIT PARTISE SE RRETHIT  
ENVER HALILI



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **“Blerje dhe instalim i sistemeve të vezhgimit për nevojat e degeve të Bankes së Shqipërisë”**

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 126,000,000 Lekë**”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Hallili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshtkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **“Blerje dhe instalim i sistemeve të vezhgimit për nevojat e degeve të Bankes së Shqipërisë”**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **09 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Ambasada: Kushtet dhe dokumentacioni për të fituar vizën, ku duhet të keni kujdes

Voltiza Duro

# Amerika hap dyert për të fejuarit, procedura e aplikimit

"Nxitoni për të aplikuar për petitionin, shqyrtimi kërkon kohë"

Të gjithë qytetarët që dëshirojnë të jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë mundësi të përfitojnë nga vizat për të fejuarit. Dje ambasada amerikane u ka bërë thirrje të gjithë personave që të fejuarit që janë shtetas amerikanë duhet të aplikojnë sa më shpejt për petitionin, pasi shqyrtimi i tij kërkon kohë. "Keni rënë në dashuri këtë verë dhe jeni fejuar? Nëse i fejuari juaj është qytetar amerikan, atëherë ai ose ajo duhet të dorëzojë petitionin për vizën K-1 pranë USCIS për ju. Duhet disa muaj për shqyrtimin e petitionit, ndaj aplikoni sa më shpejt!", - thuhet në njoftimin e ambasadës.

## VIZAT PËR TË FEJUARIT

Të gjithë ata persona që janë fejuar me një qytetar/ e amerikan tashmë kanë mundësinë të përfitojnë vizë joemigruese të tipit K-1, e cila i jep mundësinë të shkojë në Shtetet e Bashkuara. Nëpërmjet kësaj vize, shtetasi i huaj që është fejuar me një amerikan, pas zhvendosjes në SHBA



duhet që të marrohet brenda 90 ditëve pas mbërritjes e pas kësaj duhet të rregullojë statusin e tij në rezident të përhershëm të

ligjshëm me zyrat Shërbimeve Amerikane të Shtetësisë dhe Emigracionit të Departamentit të Sigurisë Kombëtare. Për shkak se

viza për të fejuarit i lejon mbajtësit të emigrojë dhe të marrohet me një qytetar amerikan menjëherë pas mbërritjes në Shtetet e

Bashkuara, atij do t'i duhet të plotësojë disa nga kërkesat e vizës së emigrimit. Ndërkaq, fëmijët e ligjshëm të aplikantëve K-1 mund të marrin vizën K-2.

## APLIKIMI

"Nëse i/e fejuari/ja juaj banon në Shqipëri, zyra jonë në ambasaden amerikane në Tiranë pasi merr petitionin e përpunuar nga NVC, do të dërgojë udhëzime të detajuara mbi dokumentacionin e kërkuar dhe vizitën mjekësore të kërkuar", - nënvizohet në faqen zyrtare të ambasadës amerikane. Ndërkohë kandidatit gjatë intervistës do t'i merren shenjat e gishtërinjve elektronikisht e madje në disa aplikime vizash mund të jetë i nevojshëm procesi administrativ, që kërkon kohë shtesë pas përfundimit të intervistës nga zyrtari kon-

sullor. Shumica e proceseve administrative zgjidhen brenda 60 ditëve nga dita e intervistës, por gjithsesi, kohëzgjatja varet nga rrethanat individuale të çdo rasti. Ndërkohë, fëmijët e aplikantëve për vizë K-1 mund të aplikojnë për vizën e llojit K-2, ndërsa një aplikim i veçantë duhet dorëzuar për çdo kandidat të vizës K dhe çdo aplikant i kësaj kategorie vize duhet të paguajë tarifën e kërkuar. Ndërkohë edhe shtetasi amerikan duhet të kryejë aplikimin nga ana e tij me formularin "I-129F, petition për të fejuarin/ën e huaj" në zyrat e emigracionit në SHBA. Në fund të intervistës për vizën emigruese, zyrtari konsullor do të informojë kandidatin nëse aplikimi i tij për vizë miratohet ose refuzohet.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

## TRANSFEROHU NË UET

MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR

DATA 03-13 Shtator 2018

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn



BORA ZEMANI E DASHURUAR? JA PËRGJIGJJA E SAJ PËR FANSAT

# SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETË SIKRIPITARE

E premte 14 Shtator 2018



**Eni Koçi paralajmëron fansat për bashkëpunimin e ri**



**Si e humbet kontrollin Morena Taraku?**

**BULEVARDI POLITIK**



- E përjashtoi Rama, Gjetani: S'ka bir nëne të më largojë nga grupi i PS
- Donald Lu takon Metën e Kryemadhin, ja dhurata që mori
- Namik Dokle marton djalin, shend e verë me Veliain
- Ditëlindja e Mimi Kodhelit bën bashkë PS-në e LSI-në në Londër, torta e veçantë nga djemtë e Hasit



Reagon këngëtarja e njohur për të përgënjeshtuar shtatzëninë e së bijës

# MARINA FARËS

## i thyhet përsëri zemra, ja detajet e ndarjes së çiftit

*Historitë që nuk patën fund të lumtur*



**Reagon këngëtarja e njohur për të përgënjeshtuar shtatzëninë e së bijës**

# Marina Farës

## i thyhet përsëri zemra, ja detajet e ndarjes së çiftit

*Historitë që nuk patën fund të lumtur*

**Egla Xhemali**

Ajo është një nga vajzat më të komentuar të show bizit për bukurinë, trupin perfekt si dhe për lidhjet që nuk kanë fund të lumtur. E kemi fjalën për Marina Farën. Bukuroshja, e cila është diskutuar mjaftueshëm në media këto kohë për lidhjen me djaloshin nga Laçi u ka dhënë fund pikëpyetjeve të mëdha. Ajo ka hequr të gjitha foto me të dashurin nga llogaria e saj në "Instagram" dhe nuk është më përdoruese e tij. I gjithë ky mister që kaploi botën rozë nisi me ndryshimin e beftë të Marinës që prej kohësh është munduar ta mbaj larg mediave jetën personale, pasi në rrjetet sociale u përhap lajmi se është shtatzënë. Ajo në llogarinë e saj muajt e fundit kishte "shpërthyer" me imazhe e video nga më të ndryshmet, ku çifti shiheshin bashkë dhe i shkëmbenin njëri-tjetrit putheje e dashuri. Edhe më të dyshimtë gjithë këtë supozim rreth ndarjes së Marinës nga i dashuri i saj, e bëri qarkullimi i imazhit ku ajo shihet në një klinikë gjinekologjike duke bërë kontroll. U tha se Fara është në muajin e tretë të shtatzënisë gjë që nuk u pohana kurrë nga ana e saj. Me shumë gjasë çifti nuk janë pajtuar me njëri-tjetrin rreth ardhjes në jetë të një fëmije, gjë që dyshohet se mund të jetë edhe shkaku kryesor i ndarjes. Këto ditë Marina vendosi t'u kthehet përsëri rrjeteve sociale. Natyrisht, që lajmi për një shtatzëni të mundshme ka sjell dhe reagimin e Eli Farës, të ëmës. Këngëtarja e njohur ka postuar në "Instagram" një foto të së bijës, ku kjo e fundit duket në super formë me barkun jashtë. Duket se Eli do t'u mbyllij gojën të gjithë atyre që po aludojnë për një shtatzëni të mundshme të vajzës. Ndarja nga i dashuri nuk është e vetmja që i ka thyer zemrën bukuroshes. Raporti i lumtur që pati për një kohë të shkurtër me biznesmenin nga Shkodra është një rast tjetër që e ka lënduar atë. Me shpalljen e fejesës në 31-vjetorin e saj, Marina mori një unazë diamanti nga 40-vjeçari, ndërkohë që nuk bëhej e ditur se ku u njoh çifti. Më vonë u zbulua se ata ishin njohur nga një shoqëri e përbashkët e Elit, me disa menaxherë arti dhe një rethi artistësh që frekuentonin



të njëjtin lokal në Tiranë. Asokohe qarkulluan në internet foto të realizuar gjatë festës së ditëlindjes së vajzës së Eli Farës, të cilat i publikoi edhe ai vetë në profilet e tij në rrjetet sociale për t'u treguar vajzave që mund t'i kenë vënë syrin për shkak të pa-

surisë, pasi ai nuk ishte më beqar. Marina ka preferuar gjithmonë që t'u qëndrojë larg situatave, të cilat e vënë atë në epiqendër të komentëve. Sidoqoftë, ne urojmë që Marina të mos përjetoj më histori të trishtta dhe gjithçka të rrjedhë siç bukuroshja do.



**Ajo është një nga emrat më të përfolur në mediat rozë, shkruan Gazeta Blic.** Flasin për vajzën e këngëtares, Eli Fara, Marinën e cila komentohet shumë për provokimet që bën në rrjete sociale. Duke qenë se është shumë aktive me postime, çdo fotografi është më provokuese se tjetra. Jo vetëm për paraqitjet provokuese, por Marina Fara komentohet shumë edhe për lidhjet e saj. Ka vetëm pak muaj që ajo është

ndarë nga i fejuari, të cilin vet e bëri publike në një postim në Instagram, por që ajo fejesë zgjati shumë pak, vetëm dy muaj, shkruan Gazeta Blic. Arsyet e ndarjes ajo nuk i bëri të ditura asnjëherë. Mirëpo, shumë shpejt vajza e Eli Farës u shfaq në krahët e një maskulli tjetër, ku dhe po publikon fotografi të ndryshme me të, por gjithmonë duke i fshehur fytyrën. Ajo në llogarinë e saj muajt e fundit kishte "shpërthyer" me imazhe e video nga më të ndryshmet ku çifti shiheshin bashkë dhe i shkëmbenin njëri-tjetrit putheje e dashuri. Edhe më të dyshimtë gjithë këtë supozim rreth ndarjes së Marinës nga i dashuri i saj, e bëri rrjedhja e imazhit ku ajo shihet në një klinikë gjinekologjike duke bërë kontroll. Në informacionet që shumë media në Shqipëri i kanë publikuar thuhet se tashmë Fara është në muajin e tretë të shtatzënisë. Ka shumë gjasë që çifti nuk janë pajtuar mes vete rreth të bërit fëmijë gjë që dyshohet se mund të jetë edhe shkaku kryesor i ndarjes. Sido që të jetë, Marina Fara vazhdon të mbetet një nga vajzat më joshëse shqiptare e cila gjithmonë di të marrë vëmendjen mediatike qoftë me linjat e bujshme trupore qoftë edhe jetën e saj e cila jo çdo herë është brenda kufijve të privates. Vlen të theksohet se i(sh)dashuri i Marina Farës sipas burimeve të JOQ gjendet në burg dhe është i fejuar.





## Eni Koçi paralajmëron fansat për bashkëpunimin e ri

**P**ak ditë më parë këngëtarja Eni Koçi zbuloi me anë të një fotoje në 'Instagram' se shumë shpejt do publikojë një projekt të ri muzikor me titullin 'Zemër'. Dyshimet ishin se pas disa bashkëpunimeve, Eni do të vinte me një këngë solo, por mesa duket nuk është ky rasti. Këtë herë bashkëpunëtori i saj është vokalisti i grupit 'NRG Band', Besnik Qaka. Të dy kanë publikuar foto nga xhirimet, në të cilin mesa duket do të jenë edhe protagonistë. Kujtojmë se bashkëpunimi i fundit i Enit ishte me Mc Kresha në këngën 'Gabimet'.



## Si e humbet kontrollin Morena Tarku?

**H**umbja e kontrollit me siguri i ndodh të gjithëve dhe secili ka mënyrën e vet sesi i përjeton këto momente kur stresi bllokton veprimtarinë normale të trurit njerëzor. Ju me siguri keni mënyrën tuaj se si ju ndodh ky "proces", por a e dini se si e humbet kontrollin Morena Tarku? Këtë e ka treguar vetë këngëtarja me disa video të postuara në "Instastory", ku shihet një majmun i lezetshëm teksa lanë enët. S'e paska keq Morena! Të paktën humbjen e kontrollit e përcjell me një veprim pozitiv.



## Bora Zemani e dashuruar? Ja përgjigjja e saj për fansat

**B**ora Zemani është një nga moderatorët, e cila u përfol gjatë pas ndarjes nga Vin Veli. Së fundmi, moderatorja ka përdorur aplikacionin e fundit të "Instagram", ku fansat e saj i kanë drejtuar pyetje të ndryshme megjithëse ajo ka zgjedhur të publikojë vetëm disa nga ato. Njëra nga pyetjet ishte nëse ishte e dashuruar, e moderatorja preferon të kthejë përgjigjen 'jam e lumtur'. Po ashtu ajo ka treguar se gjatë shtatzënisë ka shtuar 28 kilogram, por që i ka hequr me kalimin kohës.



## Arbana Osmani më në formë se kurrë

**V**ideoklipi i fundit i këngëtares shqiptare Linda Halimi bëri shumë bujë në media. Skenat e 'nxehta', që shfaqnin këngëtares duke shkëmbyer puthje me një vajzë u komentuan pafund. Ndërsa vetë Linda pranoi se kjo këngë ishte një eksperiment. Në një intervistë televizive Linda ka folur për detajet e klipit. "Unë jam person shumë i rezervuar. Gjërat intime i kam ruajtur për në dhomën e gjumit. Skena ka qenë shumë e sikletshme, sepse ne duhet të silleshim sikur ishim vetëm, ndërsa pas kamerës ishin pesë persona të ndriçimit dhe grimierë, pra të gjithë ata që po punonin me ne. Na u desh ta përsërisnim puthjen gjashtë herë. I vetmi problem dhe dallim ishte buzëkuqi. Ngaqë i kishim të dyja buzët e lyera, sa herë na duhej të përsërisnim puthjen, duhet të lanim dhembët dhe të lyenim buzët sërish",-ka shpjeguar Linda. Më tej këngëtarja zbuloi se ideja për atë skenë ishte e regjisorit të klipit dhe kjo zgjedhje nuk ishte frymëzuar nga kënga e Rita Orës, siç është përfolur së fundmi.



## E përjashtoi Rama, Gjetani: S'ka bir nëne të më largojë nga grupi i PS

Deputeti Gjetan Gjetani u përjashtua pak ditë më parë nga grupi parlamentar i Partisë Socialiste, pas një statusi në "Facebook", ku akuzonte Policinë e Shtetit si të inkriminuar dhe të lidhur me krimin. Rama e shkarkoi rufeshëm deputetin Gjetani në Asamblenë e Partisë Socialiste, pasi sipas kryeministrit, Gjetani kishte bërë presion për të emëruar shefa policie në Kurbin. Pak ditë pas përjashtimit, Gjetani duket se e ka marrë me sportivitet largimin. Në disa foto të shpërndara në "Facebook" nga fotografi Agim Rama, Gjetani shfaqet i shoqëruar nga deputetë socialistë. Vetë fotografi e shoqëron postimin me dixhiturën: "Speciale, deputeti Gjetan Gjetani, s'ka bir nëne që më largon nga grupi parlamentar i PS-së". Mbetet për t'u parë si do të vijojë marrëdhënia e Gjetanit me grupin e socialistëve.



## Donald Lu takon Metën e Kryemadhin, ja dhurata që mori

Në një postim të bërë publik në rrjetin social "Facebook", Presidenti i vendit, Ilir Meta ka shprehur kënaqësinë që pati gjatë një dreke lamtumire me ambasadorin në largim, Donald Lu. "Kënaqësi të kaloja një drekë lamtumire me ambasadorin e SHBA, z.Donald Lu, me të cilin bashkëpunuam për mëse tri vite për intensifikimin e marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Me këtë rast e urova ambasadorin për suksese në detyrën e re!", ka shkruar Meta. Ndërkohe, Lu ka pasur një takim edhe me kryetaren e LSI, Monika Kryemadhin, ndërsa kjo e fundit në formë simbolike i ka dhuruar një jelek me motive popullore tradicionale shqiptare dhe një qeleshe.



# BULEVARDI POLITIK

*Na merrni seriozisht!* 😊

## Namik Dokle marton djalin, shend e verë me Veliajn

Bleron Dokle, djali i ish-deputetit socialist, Namik Dokle i ka dhënë fund beqarisë duke kurorëzuar me martesë dashurinë e tij me Ornela Belën. Por përveç festës së tyre familjare, ata kanë zhvilluar edhe një ceremoni zyrtare, teksa i janë betuar njëri-tjetrit për dashuri të përjetshme përpara kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliajt. Ceremonia është zhvilluar në tarracën e gjelbër të Bashkisë Tiranë dhe pjesë e saj ishin edhe familjarët e dhëndrit dhe nuses, të cilët u bënë dëshmitarë të këtij momenti të veçantë. I pranishëm ishte edhe ish-deputeti Namik Dokle, i cili i rrethuar edhe nga mbesat dhe nipërit e tij dhe në krah të Veliajt nuk e fsheh gëzimin e tij për martesën e djalit të tij.



## Ditëlindja e Mimi Kodhelit bën bashkë PS-në e LSI-në në Londër, torta e veçantë nga djemtë e Hasit

Ish-ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli ka festuar së fundmi ditëlindjen. Mirëpo, këtë vit kjo ditë e veçantë e gjeti Kodhelin në Londër. Ajo që bie në sy është rëndësia që i kanë kushtuar kolegët e saj, tashmë në opozitë, për ditëlindje. Fillimisht ishte deputeti i LSI, Luan Rama, ai që ndau me ndjekësit në rrjetet sociale një postim të veçantë për ish-ministren. Ndërsa së fundmi deputeti tjetër i LSI, Ylli Shehu ka ndarë pamjet nga festa private e ditëlindjes së Kodhelit. "Në ditëlindjen e Mimi Kodhelit, deputetes së Kukësit, mes djemsh të këtij qarku në Londër. Sa vjeç mbushi Mimi? E kush di ta thotë? E sigurt më pak nga të gjithë ne në këtë tryezë", shkruan Shehu në një postim në "Facebook", ku i pranishëm në tryezë është edhe Luan Rama. Ndërsa më e veçanta e kësaj feste është torta e përgatitur nga disa të rinj nga Hasi, që jetojnë në Londër. Kodheli është deputete e qarkut të Kukësit.





Vizat për Kosovën, Thaçi: Jemi një hap para lëvizjes së lirë në Shengen

# Liberalizimi i vizave për Kosovën, Parlamenti European voton pro Hahn: Vendimi i PE është i mirëpritur

Parlamenti Evropian ka votuar pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Pro rekomandimit për heqjen vizave kanë votuar 420 deputetë të Parlamentit Evropian, 186 ishin kundër dhe 22 absetuan. Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, para fillimit të votimit tha se Kosova i ka përbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave dhe ka kërkuar votën e të gjithë eurodeputetëve të Parlamentit Evropian që të votojnë me votë pro. "Kërkuam të votohej pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Nuk është një vendim përfundimtar; megjithatë është jashtëzakonisht i rëndësishëm për procesin. Dihet se Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret e kërkuar për liberalizim të vizave", - ka thënë raportuesja e BE-së për Republikën e Kosovës, Tanja Fajon. Pas votës së Komisionit Evropian, tashmë pritet edhe votimi nga Këshilli i Ministrave të BE-së. Ndërkaq, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka reaguar dhe përmes një postimi në "Facebook" në lidhje me votimin e djeshëm në Parlamentin Evropian. "Qytetarët e Kosovës janë edhe një hap më afër realizimit të një të drejte bazike në familjen evropiane, lëvizjen e lirë në zonën Shengen. Me më shumë se 2/3 e votave Parlamenti Evropian votoi pro liberalizimit të vizave për qytetarët tanë", shkruan Thaçi në postimin e tij. Për Presidentin e Kosovës, votimi i djeshëm në Parlamentin Evropian është një mesazh i qartë edhe për institucionet e tjera vendimmarrëse në Bashkimin Evropian. "Jam i bindur se brenda një periudhe të shkurtër kohore do të përmbillet lirisht ky proces



Parlamenti European

**JOHANNES HAHN**  
"Drita e gjelbër e Parlamentit Evropian për të nisur negociatat me Këshillin e Evropës për liberalizimin e vizave për Kosovën, e mirëpritur".

vizave. Këtë vendim e meritojnë qytetarët e Kosovës", ka shkruar ai në "Facebook". Ndërkaq, komisioneri për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn ka mirëpritur vendimin e Parlamentit Evropian për aprovimin e rekomandimit për liberalizimin e vizave për Kosovën. Hahn në një postim në "Twitter" thekson se tashmë Parlamenti Evropian ka dhënë dritën e gjelbër për të nisur negociatat me Këshillin e Evropës për liberalizimin e vizave. "Drita e gjelbër e Parlamentit Evropian për të nisur negociatat me Këshillin e Evropës për liberalizimin e vizave për Kosovën, e mirëpritur".

**HASHIM THAÇI**

"Qytetarët e Kosovës janë edhe një hap më afër drejt realizimit të një të drejte bazike në familjen evropiane, lëvizjen e lirë në zonën Shengen. Me më shumë se 2/3 e votave, Parlamenti Evropian votoi pro liberalizimit të vizave për qytetarët tanë".

dhe qytetarët tanë pas një rrugëtimi të gjatë dhe tejet të mundimshëm, së shpejti do të jenë të barabartë me të gjithë qytetarët e Bashkimit Evropi-

an. Si President i Republikës së Kosovës, në emrin tim personal dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës, i falënderoj eurodeputetët për këtë ven-

dim të drejtë", - përfundon Thaçi. Një tjetër reagim ka ardhur edhe nga kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa. Përmes një postimi në "Facebook" Mustafa theksoi se kjo fitore ishte e përbashkët, e BE dhe institucioneve të Kosovës që përbushën kriteret. "Të shpresojmë, por edhe të punojmë që edhe Këshilli i Ministrave të BE-së në të ardhmen e afërt të vendosë pozitivisht për liberalizimin e

**SHKURT**

**Kaliforni, masakër me 6 të vrarë**

Një masakër e vërtetë me 6 persona të vrarë ka ndodhur në qytetin e Bakersfield, në Kaliforni. Sipas 'BBC', një çift, burrë e grua shkuan me makinë në një parkim kamionësh, në një zonë të qytetit dhe pikërisht këtu burri qëlloi për vdekje gruan dhe dy persona të tjerë. Më pas ai u largua drejt një banese, ku vrau edhe dy të tjerë. E tekta tentoi të largohej, ai rrëmbeu një makinë, brenda së cilës ndodhej një grua dhe një fëmijë, ku u përball me një oficer policie dhe qëlloi voten për vdekje. Shkaqet e kësaj ngjarjeje të rëndë nuk dihen ende. Autoritetet policore atje thanë se po përpigjen të përcaktojnë përse nisi gjithçka dhe përse autori kishte në shënjestër kaq shumë persona, pasi vrasjet janë dukshëm të lidhura me njëra-tjetrën. Kreu i policisë në Kern County, Donny Youngblood shpjegoi se e gjithë masakra kishte ndodhur në një hark kohor prej 10-15 minutash.

**Uragani "Helene"**

**kërcënon Europën**

Një stuhi po shpërthen në brigjet e Shteteve të Bashkuara dhe paralajmërimet mund të vlejnjë edhe për Britaninë e Madhe, thonë parashikuesit. Uragani "Helene" do të vërshojë në Oqeanin Atlantik vetëm pas "Florence", një stuhi "përbindëshe", e cila pritet të sjellë "përmblytje katastrofike" në Karolinën e Jugut dhe të Veriut. Ndërsa "Florence" nuk pritet të paraqesë ndonjë rrezik për Britaninë, uragani "Helene" mund të sjellë shira me erë të hënën. Alex Deakin, një meteorolog në "Met Office", ka thënë se zhvillimet rreth stuhisë do të ndikojnë shumë pak në Mbretërinë e Bashkuar në fillim të javës së ardhshme. "Ka shumë pasiguri rreth zhvillimeve të sistemit të presionit të ulët. Kjo mund të sjellë një mot të ngrohtë, por mund të sjellë gjithashtu një mot mjaft të lagësht me erë dhe potencialin për një mot ekstrem", u shpreh Deakin. Ndikimi në Britani do të jetë i behtë në krahmasim me motin e egër për shkak të goditjes së bregut të Karolinës, që do të ndodhë në vonë gjatë kësaj jave. Uragani "Florence" është konsideruar uragan i rrezikshëm i kategorisë 3 dhe me erërat që shkojnë në 130 milje në orë. Pritet të arrijë në bregun lindor të enjtes onje të premtën herët dhe do të përshkruhet si një stuhi "kërcënuese për jetën".

**Ofensivë diplomatike, Mogherini, Mitchell dhe Bushati në Shkup**

**Referendumi për emrin, opozita në Maqedoni zbut qëndrimin**

Ditën e djeshme Shk Dupi u "vërshua" nga vizitat e personaliteve të rëndësishme të politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare. Përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federika Mogherini, ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, Wes Mitchell si dhe ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati do të qëndrojnë në Shkup për t'u dhënë mbështetje autoriteteve të vendit dhe për t'u bërë thirrje qytetarëve që të mbështesin referendumin e emrit, që do të zhvillohet më 30 shtator - informon INA. Ministri Bushati prej ditës së mërkurë po qëndron për vizitë në Shkup, ku takoi kryeministrin Zoran Zaev dhe liderët të partive

politike të Lëvizjes 'Besa' dhe partive tjera. Agjenda e takimeve të tij filloi dhe në mëngjes me kryeparlamentarin Talat Xhaferi, ministrin e Jashtëm Nikol Dimitrov dhe zv.kryeministrin për Eurointegrim Bujar Osmani. Zyrtarja e lartë e BE-së, Mogherini nisi axhendën e takimeve gjatë pasdites, ku u takua me kryeministrin Zoran Zaev dhe liderët politikë. Ndërkaq, pas një debati maratonë, partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE mori vendim përfundimtar për referendumin e 30 shtatorit. Sipas VMRO-DPMNE-së, çdo qytetar duhet të vendosë vetë se a do të votojë dhe se si do të votojë në referendumin për emrin më 30 shtator. Megjithatë VMRO do të zhvillojë fushatë aktive, ajo nuk do t'i udhëzojë qytetarët që të bojkotojnë referendumin,

të votojnë pro apo kundër Marrëveshjes së Prespës. "Kjo nuk është çështje vetëm e VMRO-DPMNE-së apo LSDM-së, por e tërë Maqedonisë. Në këtë moment historik, VMRO-ja pas konsultimit me qytetarët për bojkotim apo kundërshtim të referendunit dhe pas konsultimeve me ndërkombëtarët dhe anëtarët e partisë, e ka vlerësuar sërish marrëveshjen si të dëmshme për Maqedoninë, prandaj ne do t'u ua lemë qytetarëve që vendimin për referendumin ta marrin në bazë të vlerësimit vetjak. Dëgjoni zemrën tuaj dhe veproni si duhet", ka deklaruar kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski. I cili më pas shtoi: "Në fund Maqedonia do të fitojë".

**Lista Serbe s'e mbështet formimin e ushtrisë kosovare**

**Kreu i Kosovës: Ushtria bëhet në koordinim me partnerët ndërkombëtarë si në 2014-ën**

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dje në konferencën për media është pyetur edhe rreth transformimit të FSK-së në ushtri të Kosovës. Sipas burimeve diplomatike, këto ditë disa ambasada të huaja janë alarmuar sërish me ngritjen e kësaj teme nga zyrtarë qeveritarë, të cilët u kanë thënë se qeveria planifikon ta procedojë së shpejti në Kuvendin e Kosovës projektligjin me të cilin do të themelohet ushtria e Kosovës. Presidenti Thaçi ka thënë se nuk është i informuar dhe nuk beson se janë të informuar as partnerët, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja. Thaçi është shprehur se propozimi i tij dallon nga rrethanat aktuale, sepse kur ka propozuar, ka qenë një mbështetje e plotë e SHBA-ve dhe NATO-s në vitin 2014, mirëpo për shkak të ngurtësimit, e kokëfortësisë dhe egove elektorale, sipas Thaçit, nuk kanë arritur ta kalojnë në Kuvend. Nga ana tjetër, nënkryetari i Listës Serbe dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Igor Simić deklaroi për Radion Evropa e Lirë se partia e tij nuk do ta mbështesë formimin e Ushtrisë së Kosovës. "Formacioni i vetëm ushtarak legal në Kosovë, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është KFOR-i, i cili në këto hapësira ka ardhur me pajtimin e Republikës së Serbisë", ka thënë Simić. Reagimi i zyrtarit të Listës Serbe ka ardhur pasi Qeveria e Kosovës në mbledhjen e sotme ka miratuar pakon e projektligjeve që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj ka bërë të ditur se Qeveria e Republikës së Kosovës, siç ka thënë ai, konform me përbushjen e agjendës së saj, i ka miratuar tri ligjet që kanë të bëjnë me procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si e drejtë kushtetuese e saj dhe si përgjigje nevojave të konsolidimit të brendshëm të shtetit.

FIGURAT HISTORIKE

# REXHEP QOSJA:

## Kur fyejnë Ismail Qemalin e Mithat Frashërin

Nga Rexhep Qosja

Në qoftë se shkoni te varret e Prishtinës, për të marrë pjesë në ndonjë varrim apo për të vënë lule në varrin e një familjari, të afërmi a miku, kur të ktheheni nëpër rrugën që lëshohet teposhtë, ndaluni e shikoni djathtas dhe besoj se do të shihni edhe diçka që s'e keni parë dhe që s'do të donit ta kishit parë.

E do të shihni dy rrugica, të shënuara për t'u mbajtur në mend.

E para, është rrugica në fillim të së cilës, në anën e poshtme, të majtën, është vënë një si tabelë me emrin e babait të Shqipërisë, babait të shtetit të parë shqiptar, Ismail Qemalit. Si duket ajo tabelë, si duket mbajtësja e asaj tabelë, si duket i gjithë fillimi i asaj rrugice me emrin e Ismail Qemalit? Vëshetrojeni mirë foton që po ia bashkëngjis këtij postimi! Jam i bindur se pamja që do të shihni do t'ju pikëllojë e do t'ju mërzisë pamasë! Është një përmendore e Ismail Qemalit në sheshin para ndërtesës së dikurshme të Rilindjes së dikurshme e rrethuar me një rrethojë që s' mundëson të shihet sa duhet e si duhet ajo përmendore. Në qoftë se ndaleni e i afroheni asaj përmendoreje artistike, të dinjitetshme, do të pyesni veten: po ç'do në Prishtinë edhe një Ismail Qemal, edhe një Ismail Qemal ashtu i fyer ashtu siç është fyer në fillim të rrugicës që të çon te varret e Prishtinës!

E dyta, është rrugica, dy rrugica më poshtë se ajo me emrin e Ismail Qemalit në fillim të së cilës, në anën e poshtme, të majtën, është vënë një tabelë me emrin e Mithat Frashërit, të birit të Abdyl Frashërit - ideologut dhe diplomatit të madh të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe të Lidhjes së Prizrenit. Ajo tabelë, mbajtësja e tabelës, fillimi i rrugicës me emrin e Mithat Frashërit të pikëllojnë, të trishtojnë dhe të mërzisin edhe më shumë se rruga me emrin e Ismail Qemalit. Mithat Frashëri në kohën e komunizmit ishte i mallkuar: i mallkuar në Shqipëri në shtetërore dhe i mallkuar në Kosovë! Dhe ishte i mallkuar pse kishte qenë themelues e kryetar i Ballit Kombëtar. Por ata që ia kanë vënë emrin në rrugicën pak metra para varreve të Prishtinës dhe lejojnë që emri i tij në atë tabelë, në fillim të rrugicës,



të duket aq mjerueshëm ndoshta kanë harruar: se Mithat Frashëri ishte politikan, diplomat, shkrimtar, studiues shkencor, publicist, pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit, kryetar i këtij Kongresi, anëtar i Komisionit të këtij Kongresi, që do të hartojë alfabetin e gjuhës shqipe; ishte autor i një vargu veprash letrare, publicistike e shkencore, ishte autor i veprës Shqiptarët dhe sllavët, ishte politikani dhe intelektual ndër më të shquarit shqiptarë të kohës së tij që deri në vdekje nuk

### Imazhet e dy rrugëve që të çojnë në varrezat e Prishtinës

do të pushojë të shkruajë e të flasë për copëtimin e trojeve shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër; për pushtimin e Kosovës prej Serbisë e të trojeve të tjera shqiptare prej Serbisë, prej Malit të Zi e prej Greqisë, për padrejtësitë tragjike që fuqitë e mëdha evropiane i kishin bërë popullit shqiptar. Shikojni mendueshëm fo-

tot e dy rrugicave ku janë vënë tabelat me emrat e Ismail Qemalit dhe Mithat Frashërit! Besoj se mbasi t'i shihni do të bëni pyetjen: Pse lejohet një fyerje e një përcënim i tillë i historisë dhe i kulturës sonë? Pse lejohet një fyerje e një përcënim i tillë i historisë dhe i kulturës sonë në Kosovën e lirë dhe të pavarur?

Shkojmë në varret e Prishtinës të pritur prej Ismail Qemalit e Mithat Frashërit dhe kthehemi prej varreve të Prishtinës të përcjellë prej Ismail Qemalit e Mithat Frashërit siç i pamë të fyer! A ka komunë Prishtina? A ka deputetë ajo komunë? A ka Kuvend Kosova? A ka deputetë Kosova? A ka Ministri të Kulturës, Ministri të Arsimit, a ka institucione të kulturës, që merren me historinë e me trashëgiminë tonë kulturore? A kanë deputetë Prishtina

e Kosova të cilët do ta mbrojnë historinë e Kosovës dhe historinë shqiptare në përgjithësi prej falsifikimeve, prej shpërfytyrimeve, prej privatizimeve, prej degradimit, prej mospërfilljes, prej fyerjeve, prej përcëmimeve të ndryshme që po i bëhen sot prej shumë kujt e me shumëçka, në rend të parë prej atyre që do të duhet t'i trajtonin me dinjitetin e merituar, të kujdeseshin e t'i ruanin, por hiç më pak prej disa partive, prej të pushtetshmeve dhe të partishmëve, të cilët edhe historinë kombëtare po e keqpërdorin pa skrupuj për t'u mbajtur në pushtet sa më gjatë! Deri kur? Sidomos pas vitit 1981 historia shqiptare, letërsia shqipe, figurat e mëdha historike, politike, shkencore, letrare është dashur të mbrohen prej nënçmimeve e fyerjeve që ju bëheshin prej shovinistëve serb. As pesimistët më të mëdhenj s'kanë mundur të mendojnë se këtë histori e këto figura të mëdha kombëtare sot duhet të mbrohen edhe prej shovinistëve tonë brendakombëtarë në një jeshtë të medieve tona.

### "MYRTIS: BALLË PËR BALLË ME TË SHKUARËN"



Mijëvjeçarit", tetë vjet më parë, në Samitin e Kombeve të Bashkuara për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, është "ringjallur" sot për t'u bërë një zë i fuqishëm në arritjen e Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB, veçanërisht në çështje që kanë të bëjnë me parandalimin e sëmundjeve që prekin fëmijët. E bindur në detyrën e saj humanitare, Myrtis dërgon nga Athina e Lashtë një mesazh, drejtuar krerëve të 150 shteteve anëtare të OKB-së, pjesëmarrës në Samitin e

Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke kërkuar që ata të bëjnë ç'është e mundur për të ndaluar vdekshmërinë e fëmijëve nga sëmundjet të diagnostifikueshme dhe të trajtueshme: "Vdekja ime ishte e pashmangshme. Në shekullin e 5-të para Krishtit, nuk kishim as njohuritë, as mjetet për të luftuar sëmundjet vdekjeprurëse. Por ju, njerëzit e shekullit të 21-të, nuk keni asnjë justifikim. Dispononi të gjitha mjetet dhe burimet e nevojshme për të shpëtuar

jetën e miliona njerëzve, jetët e miliona fëmijëve, të cilët, si unë, humbin jetën nga sëmundje të cilat mund të parandalohen dhe të trajtohen". Ky është edhe mesazhi që përcjell ekspozita "Myrtis: ballë për ballë me të shkuarën", që organizohet në Tiranë nën kujdesin e ambasadës greke në Tiranë dhe Agjencisë së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Rikthimi i Myrtis nuk është vetëm një shans që bota të shohë fytyrën e një vajze që luante në hyrje të Akropolis-it kur athinasit ndërtonin Partenonin. Rikthimi i saj është një kontribut i madh në shpëtimin e fëmijëve të tjerë, 2.500 vjet më vonë pas lindjes së saj, edhe në vende që ajo nuk i njohu dot kurrë.



BOTIMI

# EMILIOS SOLOMOU

## Urrejtja, gjysma e hakmarrjes

Nga Arlinda Krushi

Mes gjithë këtyre li brave që të ofron sot tregu, letërsi shqipe apo të huaj, libra publicistikë, historikë, reportazhe, *best-seller* etj., është e vështirë të përzgjedhësh dhe të zgjedhësh një libër që mban aromën dhe vlerën e vërtetë të një letërsie të mirë, që ti e ndien, ndoshta, ndër rreshtat e parë teksa nis ta lexosh dhe të prezantohesh me të. E, kështu, pa dashur mund të të qëllojë të nisësh një libër të mirë ose jo, kjo varet nga kërkesat dhe pritshmëritë e gjithsecilit në atë çka kërkon dhe gjen. Jo rastësisht, këto ditë më ra në dorë romani "Urrejtja, gjysma hakmarrjes" (botuar dhe dalë në qarkullim nga Botimet "Toena"), të shkrimtarit qipriot Emilios Solomou dhe ardhur përsosmërisht në shqip nga përkthyesi Kristo Pulla, ku para dy vitesh, solli romanin tjetër të autorit, "Ditari i një pabesie" nderuar me "Çmimin Europian për Letërsinë 2013". "Urrejtja, gjysma hakmarrjes" është rezultat i një pune të madhe të autorit, që duket i shqetësuar për fatin e vendit dhe njëjta mjaft mirë të kaluarën, shkaqet dhe pasojat e historisë, duke ndërthurur fantazinë me të vërtetën dhe të shkuarën. Një roman me një strukturë origjinale dhe karakteristike, i ndarë në seksione të vogla dhe të veçanta, në mënyrë që lexuesi të mund të kuptojë narracionin në kohë dhe hapësirë, pa ngatërruar ngjarjet, pasi secili kapitull ka numërtimin e vet shënuar me shkronja të mëdha. Me germen A kemi Aleksin, narratorin, me B, Serjidhin, historianin, me C Apostollu, policin major, dhe me D Masakrën në Dhilesi, si dhe rastet e vetëvrasjeve në vend për shkak të Memorandumit.


Është një roman edhe policor, në dukje të parë, por që mban peshën më të madhe të një romani thriller historik, që endet mes të shkuarës dhe të tashmës, midis hakmarrjes dhe detyrës, midis dashurisë dhe urrejtjes. Në një panoramë të përgjithshme, autori rreket të na japë nga fillimi në fund një histori moderne me detektivë në zbardhjen e



Një roman thriller historik për një vrasje të bujshme në Greqinë e 2013-ës

vrastjes, duke bërë një paralelizëm midis dy ngjarjeve të rëndësishme që kanë tronditur Greqinë në një kohë të largët dhe të afërt, atë të datës 21 prilli 2013, kur u vranë dhe iu prenë kokat në mënyrë të tmerrshme dy anëtarëve të Trojkës në një hotel qendror të Athinës (ngjarje e trilluar), që sipas kalendarit Gregorian, kjo datë përputhej me datën e Masakrës së Dhilesit para 143 vjetësh, domethënë më 21 prill të vitit 1870, të Enjten e Madhe. Kjo ngjarje mori shkas kur vëllezërit Arvanitaki, një nga bandat më famëkeqe të shekullit XIX, të kryesuar dhe drejtuara nga kryebanditi Tako Arvanitaki, përbëhej nga 21 persona,

Kur vëllezërit Arvanitaki, një nga bandat më famëkeqe të shekullit XIX, të kryesuar dhe drejtuara nga kryebanditi Tako Arvanitaki, përbëhej nga 21 persona, të armatosur deri në dhëmbë dhe që ndiqeshin nga ligji për disa vrasje dhe vjedhje.



të armatosur deri në dhëmbë dhe që ndiqeshin nga ligji për disa vrasje dhe vjedhje, morën peng lord Mankasterin e Britanisë, Frederik Vainerin si dhe një grup turistësh anglezë, teksa ishin duke vizuar qytetin e Marathonës në Greqi. Kjo ngjarje e rëndë, sipas historisë, për pak sa nuk sh-

kaktoi luftë. Kriza u shmang vetëm pasi Greqia ndër mori një fushatë në shtypjen e bandave që vepronin në territorin e saj.

Duke mbështetur idenë se kjo që ndodhi me anëtarët e Trojkës ishte bërë qëllimisht, dhe në favor të kësaj hipoteze flasin disa të dhëna të pakundërsh-

Pas gjyqit, banditëve të arrestuar, ua prenë kokat në publik, në po të njëjtin vend ku ishin ekspozuar më parë kokat e të tjerëve, me gijotinën e vjetër të kohës së mbretit Oton.

tueshme që i referoheshin mbajtjes peng dhe masakrimit të lordëve nga banditët - si dhe prerja e kokave të dy anëtarëve të Trojkës, që sipas Serjidhit, pedagogut të njohur të historisë, që kishte aftësinë dhe maninë të merrej me çështje që devijonin nga historia zyrtare, çështje relativisht heretike, ashtu siç i quante vetë, të guximshme, që qëndronin mbi një litar të tendosur midis ngjarjeve reale dhe hamendësimeve të pacaktuara, logjikisht, ishte një praktikë e zakonshme që zbatonin banditët dhe njesitë e ndjekjes. Në rastin konkret, pas masakrës mbi lordët në Dhilesi, më 1870, xhandarët ua prenë kokat banditëve dhe i ekspozuan në *Pedhiotou Areos*. Pastaj, pas gjyqit, banditëve të arrestuar, ua prenë kokat në publik, në po të njëjtin vend ku ishin ekspozuar më parë kokat e të tjerëve, me gijotinën e vjetër të kohës së mbretit Oton. Po ashtu, edhe vrasësit e anëtarëve të ekipit të Trojkës, i vendosën kokat e tyre në një vend të dukshëm, si të ishin trofe fitoreje. Referimi të *rrregulli i parë*, ishte ligji i parë i banditëve: Të përndiqnin dhe të zhduknin të gjithë ata që i përndiqnin. Në këtë rast nuk bëhej fjalë për hakmarrje personale. Natyrisht që anëtarët e ekipit të Trojkës nuk përndiqnin asnjë person apo persona konkretë, por i përndiqnin të gjithë pa dallim, gjithë popullin.

Por, mes këtyre dy ngjarjeve, të ndodhura në kohë të ndryshme, ajo që tronditi më shumë opinionin vendas është të dijë të vërtetën se kush ishin këta përfaqësues

të Trojkës që vinin në Greqi herë pas here? Prej nga ishin? Kush ishin historitë e tyre personale? Si mund të arrihej një ekzekutim i shpejtë i planit të ekzekutimit të tyre? Si pritet koka e njeriut? Po pastaj, si mund të fshihesh gjurmët? Sipas logjikës, ai që duhet të ketë kryer një krim të tillë ndaj të dërguarve të Trojkës, sigurisht që duhet të ketë pasur një motiv shumë të fortë. Edhe pse gjetja e autorit, nganjëherë, është si të kërkohej gjilpërën në kash-të, arsyeja vetvetiu të çon te dikush që duhet të ketë qenë tejet i zhgënjyer nga gjithçka po ndodhte në Greqi dhe gjithandaj, si papunësia, uria, taksat, vetëvrasjet, kriminaliteti, të pastrehët, ultimatumet e fuqije të huaja, europianët, liderët partiakë dhe korrupsioni, ofendimet kundër grekëve, kundër popullit të thjeshtë, gëthja e depozitave, pa shkak dhe në mënyrë provokuese, duke përhapur një mori gënjeshtërash mbi paratë të pista që qarkullonin nëpër banka etj., sigurisht që do të dilte një prej të vuariturve që t'u priste kokat... U duhej dhënë një mësim. Një formë paralajmërimi. Dikush do të dilte, nuk mund të ndodhte ndryshe. E kjo ndodhi, pikërisht në kohën dhe vendin e duhur, duke nxjerrë në shesh korrupsionin e thellë të sistemit politik dhe lidhjet e tij me fenomenin e banditizmit. Në të njëjtën kohë, do të zbulohen patogjenezat e shtetit grek që nga krijimi i tij, interesat ekonomike që vepronin në prapaskenë, por edhe ndërhyrjen e hapur të fuqije të huaja në Greqi.

Ky roman, i shkruar në një mënyrë jashtëzakonisht të zellshme mbart jo vetëm një vlerë të merituar letrare, por zbulon mjaft mirë aftësitë narrative të autorit. Me një sy kritik ndaj ngjarjeve që shënuan themelimin e shtetit grek e deri më sot, autori përcakton vendimet dhe rebelimet e një shoqërie, duke e paraqitur urrejtjen si gjysmë hakmarrje, ku pjesa tjetër është akti. Urrejtja, sipas Solomou, është ajo që armatos dorën e vrasësit, ajo urrejtje e verbër dhe e pakufishme që zhvlehtëson çdo arsye. Duke u radhitur ndër librat që do vëmendje në lexim, do të mund të mbyllet këto faqe me një kënaqësi dhe katarsis shpirtëror në çdo rresht, pasi fundi është krejt i papritur...

Opinion i Ditës

# Emri dhe tradita e mirë bëjnë gjithmonë diferencën...

Prof. Asc. Dr. Rezana Konomi

(vijon nga faqja 1)

... të ri akademik aplikantët duhet të kalojnë në disa faza, duke u përzgjedhur bazuar në kriteret e përcaktuara dhe sipas parimit të meritës dhe preferencës.

Natyrshisht që dilemat janë të mëdha, zgjedhjet e vështira dhe shpesh të ndikuara edhe nga të tjerë, por gjithmonë duke kërkuar më të mirën, studentët për veten e tyre dhe familjarët e prindërit për jetën dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre.

Për të zgjedhur më të mirët, për të zgjedhur ata që të garantojnë një të ardhme të sigurt, ata që të japin një pasaportë të garantuar në tregun e punës duhen ditur disa tregues të matshëm të performancës për të besuar dhe kuptuar se ke bërë zgjedhjen e duhur.

Kolegji Universitar "Luarasi" edhe këtë vit përmbylli me sukses fazën e parë të regjistrimeve, duke shënuar një rritje të konsiderueshme të studentëve të regjistruar në të gjitha programet e studimit që ofron për këtë vit akademik.

Për Fakultetin e Drejtësisë, rritja e numrit të studentëve që kanë kërkuar dhe zgjedhur për t'ia besuar studimet Kolegjit Universitar "Luarasi" është e pritshme, pasi Drejtësia dhe emri "Luarasi" janë një binom, i cili ka treguar besueshmëri në tregun e punës dhe mbi të gjitha, vlera të spikatura profesionale, që gjithmonë kanë bërë diferencën me të



tjerët.

Por, nuk është e vetmja arsye kjo pse zgjedhja e Kolegjit "Luarasi" ka qenë në preferencat e studentëve. Përveç emrit të mirë, tradita gjithashtu tregon për një qëndrueshmëri dhe përballje me sukses të sfidave, që aktualisht ka arsimi i lartë. Ndërkohë që certifikimi i cilësisë dhe akreditimi institucional në maksimumin e viteve që ligji për arsimin e lartë parashikon (përkatesisht 6 vite) është një

tjetër arsye e fortë e zgjedhjes së Kolegjit Universitar "Luarasi" nga ana e studentëve.

Por, procedura për aplikime ende vazhdon. Studentët kanë ende mundësi për të realizuar ëndrrën e tyre atje ku ata dëshirojnë. Në vijim janë faza e dytë dhe e tretë, të cilat korrektojnë apo plotësojnë nevojat dhe kërkesat që rezultojnë gjatë fazës së parë.

Për këtë arsye, studentët duhet të jenë të vëmendshëm gjatë plotë-

simit të aplikimeve në fazat në vijim dhe nëse dëshirojnë të zgjedhin drejtësinë si profesion të tyre, duhet të zgjedhin Kolegjin Universitar "Luarasi", si e vetmja shkollë e lartë, që garanton cilësinë maksimale në treg për këtë program studimi.

Duke marrë shkas nga fakti se ende ka shanse për të bërë zgjedhjen e duhur, këshilloj mat-urantët të jenë të kujdesshëm gjatë plotësimit të aplikimit, duke

rankuar në 10 alternativat e tyre Kolegjin Universitar "Luarasi", nëse dëshirojnë të jenë profesionistë juristë, duke i kërkuar që të informohen me maturi për të gjithë treguesit dhe elementet që e bëjnë një shkollë të lartë të jetë më e mira, me konkurruesja, më e sigurta dhe më e garantuara në tregun e punës.

Reformimi i sistemit të drejtësisë gjithmonë e më shumë do të kërkojë profesionistë të ndershëm dhe me integritet, të cilët do të dinë të përballen me sfidat që koha kërkon dhe kjo mund të arrihet vetëm nëse merr një formim të mirë dhe bashkëkohor.

Pikërisht këtë garanton Kolegji Universitar "Luarasi", Fakulteti i Drejtësisë, formëson profesionistin dhe ekspertin e së ardhmes, juristin që nesër mund të jetë magjistrat apo prokuror, i aftë të japë drejtësi dhe të kontribuojë në formimin e shtetit të së drejtës.

Për të gjitha këto arsye, por edhe për shumë elemente të tjera strukturore apo infrastrukturore, zgjidhni pa hezitim Fakultetin e Drejtësisë së Kolegjit Universitar "Luarasi". Kuotat janë të limituara, kërkesat janë të mëdha. Kujdesi gjatë aplikimeve në fazat në vijim do t'ju bëjnë të jeni pjesë e jona dhe së bashku do të zbulojmë të panjohurat dhe gjithçka të bukur që profesioni i juristit mbart.

Besoni tek ne, për të bërë realitet ëndrrat tuaja.

**\*Dekane e Fakultetit të Drejtësisë Kolegji Universitar "Luarasi"**

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ





Opinioni **i** Ditës

# Procesi "i komplikuar" i dixhitalizimit të transmetimeve

Nga Dilfirus VRIONI

(vijon nga faqja 1)

... ka kohë që bën ç'është e mundur që televizionet, radiot dhe gazetatat të marrin vëmendjen e publikut në lidhje me procesin, por me sa duket deri në momentin që u ndërpreu transmetimet për qarkun e Tiranës dhe Durrësit, të gjithë ishin "te paiterësuar".

## NJË HISTORIK I SHKURTËR

Në vitin 2012, qeveria miratoi vendimin për Strategjinë Kombëtare për kalimin nga transmetimet analoge tek ato dixhitale. Sipas vendimit, brenda datës 17 qershor të vitit 2015, asnjë televizion shqiptar nuk mund të transmetonte më në analog, por të gjithë duhet të kalonin në transmetime dixhitale. Vendimi për të kaluar në transmetime dixhitale ishte i diktuar nga zhvillimet e reja teknologjike dhe është një detyrim që Shqipërisë i rrjedh nga Marrëveshja e vitit 2006 GE 06, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës në vitin 2007.

Kalimi nga transmetimet analoge në transmetimet numerike është një proces global i detyrueshëm për të gjitha vendet, që koordinohet nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve, ndryshe i njohur si ITU. Shqipëria bën pjesë në rajonin I sipas ndarjes territoriale të ITU-së. BE dhe ITU e kanë bërë të detyrueshëm për të gjitha vendet anëtare kalimin nga analog në dixhital për arrijtjen e përdorimit në efektiv të frekuencave. Frekuencat janë pasuri e kufizuar. Transmetimi dixhital të shumë më pak hapësirë frekuencash se sa ato në analog. Ose e thënë ndryshe, për të njëjtin brez frekuencash transmetimi dixhital siguron disa herë më shumë kanale se sa ai analog.

Qershori 2015 u vendos nga GE 06 dhe më pas u mbështet edhe në Ligjin 97/2013 "Për median audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë" si afat fundor për kalimin e të gjitha transmetimeve në dixhital, detyrim ky i përcaktuar dhe i sanksionuar nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve.

Pra, siç kuptohet transmetimet që po ndërpritën në vitin 2018 në çdo qark njëri pas tjetrit, në fakt, duhet të ishin ndërprerë tre vite më parë. Nga qershor 2015 deri në shtator 2018, Shqipëria ka mbi tre vjet që shkel marrëveshjen GE 06 dhe për këtë disa herë i është tërhequr vendi nga BE. Në Progres Reportin e vitit 2018 thuhet qartë se: Shqipëria duhet të fokusohet në finalizimin e procesit të përmblylljes së digital switchover, lirim dhe identitetit dixhital, rishikimin e planit kombëtar të frekuencave me objektiva dhe targete të qarta.

"Duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, mundësitë e për-



fitimit ekonomik dhe përdorimit më efektiv të spektrit të frekuencave rekomandohet që Shqipëria të kalojë direkt në implementimin e sistemit më të avancuar DVB-T2." kështu citohet në VKM nr. 292 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të kalimit nga transmetimet analoge në ato dixhitale."

Duhet të përmendim në historinë e dixhitalizimit edhe Radio Televizionin Shqiptar, një aktor tjetër shumë i rëndësishëm i procesit, i cili ka ndërtuar rrjetin në të cilin kanë vendosur të mbështeten një pjesë e madhe e televizioneve. Rrjeti i ndërtuar nga RTSH është i teknologjisë DVB-T2, si një zgjerim i standardit ekzistues DVB-T. Një zgjerim i tillë rezulton në rritjen në 30-50% të efektivitetit të DVB-T2, kundrejt DVB-T, teknologji, e cila është miratuar më Strategjinë Kombëtare të kalimit nga transmetimet analoge në ato dixhitale.

## DIXHITALIZIMI PO NDODH

Pra, siç u kuptua, dixhitalizimi as nuk ka nisur sot, as nuk është një pikë që mund të shmanget nga AMA apo nga ndonjë institucion tjetër, ashtu sikurse edhe teknologjia që do të përdoret, pra dekodert e tipit universal DVB-T2 me ndërfaqe të përbashkët apo në rastin tjetër, televizorët që e kanë të inkuorporuar këtë tip dekoderi. Pra, kur themi duhet blerë dekodert, nuk themi duhet blerë një platformë private, por një dekodert universal, i cili ju jep aksesin në 34 kanalet pa pagesë.

Nga ana e saj AMA e ka pasur shumë të qartë rolin e përcaktuar nga Strategjia, AMA ka informuar publikun mbi procesin e dixhitalizimit të transmetimeve. AMA ka gati dhe ka shpërndarë në çdo aktivitet të saj Broshurën Informuese, ku i jepet përgjigje të gjitha pyetjeve mbi procesin. Po ashtu, edhe flutëpalosjen ku gjendet informacioni i koncentruar. Në radio

dhe televizione që nga prilli i vitit 2016 janë dhënë rreth 300 intervista nga specialistë dhe teknikë të AMA-s ku kanë shpjeguar aspekte të veçanta të procesit. Reklamata nuk është shpjeguar ata teknike nuk kanë munguar përgjatë gjithë periudhës së fushatës së informimit të publikut. Dy numra telefoni kanë qenë në dispozicion të të interesuarve mbi procesin që nga prilli 2016. Po ashtu, janë organizuar takime me operatorët edhe konferenca ndërkombëtare në lidhje me dixhitalizimin e transmetimeve, janë publikuar edhe botime shkencore. A mund të bëhet më shumë? Natyrisht që mund të bëhet.

Siç e kuptoi i gjithë publiku transmetimet dixhitale operojnë me sukses tanimë në qarkun e Beratit, Fierit dhe Korçës. Sa për qarkun e Tiranës dhe Durrësit disa herë është shtyrë afati për të filluar transmetimet dixhitale, kjo sepse njerëzit nuk kanë qenë gati, si me shumë mundësi nuk do ishin bërë asnjëherë gati, duke filluar së pari, nga familja ime. Prindërvetë mi ua kisha thënë disa herë që transmetimet do të ndërpriteshin në datë 10 shtator, por ata nuk me morën seriozisht derisa në mëngjesin e datës 10 shtator televizori nuk po shfaqte asnjë kanal.

Në këtë pikë dua të qartësoj, se kanalet në datën 10 shtator ishin në transmetim me programet që ato ofrojnë. Asnjë kanal nuk u ndërpre sinjali nga AMA. Të gjitha familjet e pajisura me dekodert DVB-T2 apo me aparat televizori që e ka të inkuorporuar këtë lloj dekoderi vazhduan të shihnin të qetë transmetimet. Të tjerët, ata që prej prillit 2016, nuk i kishin dëgjuar thirrjet e AMA-s për kalimin e transmetimeve nga analoge në dixhitale, mbeten pa sinjal, kjo si neglizhencë e tyre. Por, është i dalleshëm fakti që AMA, nuk i ka

mohuar informacionin qytetarit. Nga ana tjetër, si institucion që ka detyrime për të përmbyshur duhet që ta kryejë procesin dhe ta përfundojë në gjithë territorin e vendit. Pra, AMA nuk ka shkelur asnjë të drejtë Kushtetuese të Popullit të Republikës së Shqipërisë. Qytetarët, besoj se me interesin e lartë që kanë për median audiovizive, do t'ia krijojnë kushtet vetes për të pasur pajisjet e duhura teknologjike, tani që e kuptuan ku konsiston procesi, i cili nuk ka kthim mbrapa. Deri më sot 88 mijë dekodera janë shpërndarë falas për familjet që janë përfituese të skemës së ndihmës sociale, të mundësuar këto nga qeveria, siç i është shvencionuar për vitin e parë taksa për mbajtjen e rrjetit të televizioneve lokale, rajonale, në një prej platformave dixhitale që operojnë në treg.

Shqipëria është i vetmi vend në rajon dhe Europë që akoma nuk e ka kryer procesin. E dimë që për shumë prej familjeve shqiptare është i vështirë përgafimi i një teknologjie të re. Ky proces ka marrë kohën e tij edhe në vendet fqinje. AMA nga ana e saj është e angazhuar me gjithë stafin, që informacioni të shkojë te qytetari dhe të kalohet ky moment delikat. Po ashtu, kërkohet edhe mbështetjen e gazetarëve, opinionistëve dhe kujtudo që ka akses në publik që të ndihmojë për të qartësuar situatën dhe jo për të krijuar konfuzion.

Dixhitalizimi po ndodh, ky është lajm i mirë, le të mendohejmë të gjithë bashkë që lajmi i mirë të përbëjë lajm. Askush nuk do mbesë pa sinjal, të gjithë do kenë në shpëtitë të tyre, transmetime me cilësi më të mirë dhe larmishmëri më të madhe programesh.

\* **Përgjegjëse për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikun në AMA**

## HOROSKOPI

### DASHI

Njerëzit përreth jush do t'ju kërkojnë shumë, por mos premtoni më shumë seç keni mundësi. Mos u stresoni vetëm për të kënaqur të tjerët. Tregoni kujdes të veçantë për financat. Nuk është dita e duhur për të udhëtuar. Progresi i ngadalshëm në punë, do t'ju shkaktojë disa probleme.

### DEMI

Mos e dënoni veten pa arsye, pasi kjo do t'ju ndikojë negativisht në gjendjen tuaj mendore. Ka gjasa të bëni disa ndryshime në arkitekturën e shtëpisë. Disa ide të reja do t'ju sjellin produktivitet. Do të përballemi me disa probleme në jetën bashkëshortore.

### BINJAKET

Përpuni të kuptoni anëtarët e familjes suaj. Ka gjasa të humbni qetësinë gjatë një debati, por bëni kujdes me fjalët pasi mund të pendohej më vonë. Marrëdhënia me partnerin/partneren tuaj mund të ndërlikohet për shkak të ndërrhyes së dikujt tjetër.

### GAFORJA

Nisni jogën dhe meditimn për të qenë psikologjikisht dhe fizikisht në formë. Shmangni investimet gjatë ditës së sotme. Miqtë mund të përpun t'ju çorientojnë. Bëni shumë kujdes kur të filsi me disa njerëz të rëndësishëm.

### LUANI

Mos i tregoni qëllimet tuaja për të ardhmen. Në shtëpi do t'ju vijjnë disa miq me të cilët do të kaloni një kohë të mrekullueshme. Ka gjasa të përfshihen në një marrëdhënie të romantike.

### VIRGJERESHA

Do të shqetësoheni shumë nga tensioni në punë. Duhet të punoni për disa çështje, të cilat nuk i keni zgjidhur ende. Mos ia impononi mendimin tuaj të tjerëve. Ka gjasa që të realizoni një udhëtim të papritur.

### PESHORJA

Duhet të kontrolloni ndjenjat. Fëmijët do t'ju kërkojnë më shumë vëmendje. Nuk do të ndiheni mirë nga fjalët që do t'ju thotë partneri/partnerja juaj, por bëni kujdes me fjalët pasi mund ta përkeqësoni situatën.

### AKREPI

Pikëpamjet e ndryshme me dikë do t'ju çojnë drejt një debati. Financat tuaja do të rriten në pjesën e dytë të ditës. Një i afërm do të irritohet nga sjellja juaj e paparashikuar. Në punë do të kaloni një ditë shumë të qetë, ndryshe nga disa ditë të mëparshme.

### SHIGJETARI

Disa ndryshime në look do t'ju bëjnë të ndiheni shumë mirë. Do të përballemi me një situatë të vështirë, por mos i merrni personat përreth, pasi mund të mbeteni vetëm. Sot do të dli me partnerin/partneren tuaj dhe do të kaloni momente të mrekullueshme.

### BRICJAPI

Duhet ta kaloni më shumë kohë pranë familjes suaj, çfarë do t'ju mbushë me energji. Miqtë do t'ju japin disa këshilla të rëndësishme sa i përket jetës suaj personale. Përdorni inteligjencën dhe influencën tuaj për të zgjidhur disa çështje në punë.

### UJORI

Disa persona rreth jush premtojnë më shumë seç kanë mundësi, ndaj shmangni ata pasi nuk japin rezultat. Nuk ka rëndësi sesa mund të grindesh me partnerin/partneren tuaj, pasi në fund të ditës do të jeni sërish bashkë.

### PESHQIT

Look-u juaj sot do t'ju lërë pa fjalë njerëzit rreth jush. Shmangni personat që iu afrohen vetëm për interes. Sot do të fokusoheni në çështje shumë të rëndësishme. Ka gjasa të përdorni disa momente të vështira në jetën tuaj bashkëshortore.

Vitin e shkuar Lacio nuk arriti vendin e katërt për fare pak, por këtë vit kryeqytetasit janë gati ta provojnë që të arrijnë veprimtarinë aq shumë të dëshiruar. Këtë ua ka premtuar tifozëve Tomas Strakosha, që beson shumë se ai dhe shokët e tij do të arrijnë të kualifikohen në Ligën e Kampioneve. Tani për tani përqendrimi maksimal i kushtohet Empolit, sfidës së radhës në kam-



### Portieri i Kombëtares ua premtonte tifozëve

## Strakosha lëshon kushtrimin: Lacio, duhet të shkojmë në Champions

pionat, teksa kryeqytetasit do të provojnë të vijnë edhe në stadiumin "Castellani" serinë e fitoreve që nisi me Frozinonen. Portieri i Kombëtares së Shqipërisë mbremë ishte për darkë në një restorant shumë të famshëm japonezo-brazilian të Romës dhe u ka pohuar disa tifozëve prezent në restorant se është i bindur të cilësitet e Lacios dhe se "skuadra bardhekaltër është gati të luftojë për të siguruar pjesëmarrjen në Europën që vlen". Sikundër shkruan iltempo.it, skuadra ka cilësi dhe trajneri është në gjendje që të bëjë diferencën për të bërë realitet ëndrrën në fotofinish, ëndërr që nuk u realizua majin e shkuar.

### PRESIDENTI I NAPOLIT



### De Laurentis: Jam gati të blej Hajdukun e Splitit

Pasi bleu Barin, i cili sezonin e kaluar fallimentoi dhe përfundoi në Serinë D, presidenti i Napolit, De Laurentis, nuk ndalet. Ai ka shprehur gatishmërinë për të blerë që klubi është në duart e tifozëve dhe ata nuk duan në asnjë mënyrë që klubi të privatizohet. Jam gati të bisedoj, por jo me tifozët, sepse duhet të flas me ndokënd nga drejtuesit. Kam blerë Barin kohë e fundit. Kryebashkiaku Antonio Dekaro pranoi ofertën time, por kjo nuk do të thotë që nuk më intereson të blej edhe Hajdukun. "Jam befasuar që Edi Reja është gati të marrë drejtimin e skuadrës, sepse ai ka refuzuar edhe Napolin në të shkuarën. Reja më ka thënë që klubi është në duart e tifozëve dhe ata nuk duan në asnjë mënyrë që klubi të privatizohet. Megjithatë, Hajduku është në veshitirësi dhe unë do investoja, para, njerëz dhe shumë pasion. Nuk do lejoja kurrë që një klub me histori e traditë si Bari të përfundojë në divizionin e katërt. Investoj njohturi, para dhe shumë pasion për futbollin".

Mbrojtësi i rikthyer në superligë shpalos objektivat, ndërsa parashikon një garë të fortë

# Cuculi: Me Kukësin dua kupën dhe kampionatin!

*Përballja më e veçantë, ajo ndaj Partizanit*



Jeton Selimi

Një nga afrimet e kësaj vere të Kukësi, ishte mbrojtësi Ardian Cuculi, i cili mbylli aventurën me Shkëndijen dhe u rikthye në Kategorinë Superiore. Ai është një lojtar që e njih mirë Superiore, duke qenë se në të kaluarën ka luajtur me Partizanin, ku edhe ishte ndër më të dalluarit. Në një rrëfim për "Vipsport.al", Cuculi ka folur në lidhje me ambientimin të Kukësi, ndeshjet e verilindorëve, por edhe për objektivat që klubi ka. I pyetur në lidhje me ekipet që i sheh si pretendente këtë sezon, Cuculi ka treguar se të gjitha skuadrat janë rritur, ndërkohë që ka treguar edhe ndryshimet që ka gjetur në futbollin shqiptar. Natyrisht, Cuculin e pret edhe një ndeshje mjaft e veçantë në Shqipëri, pasi përballë do të ketë Partizanin, skuadër me të cilën ka luajtur për disa vite. Ai shprehet se nuk i trembet një reagimi negativ nga tifozët e kuq, duke shprehur se gëzon respekt për to.



**Ambientimi të Kukësi?** Jam ambientuar mirë. Të gjithë çunat pa përjashtim më kanë pritur shumë mirë gjë që ma ka bërë edhe ambientimin më të lehtë. Të gjithë në klub, kanë një harmoni shumë pozitive mes tyre.

**Ndeshja me Tiranën?** Ishte fitore e rëndësishme

me Tiranën për ecurinë e mëtjeshme. Dy ndeshjet e para luajtëm mirë mirëpo mungonte vetëm rezultati kështu që fitorja me Tiranën ka mundësi që të punojmë në qetësi gjatë 2 javëve pushim.

**Takimi i radhës ndaj Teutës.** Ndeshja me Teutën është e vështirë pasi kundërshtari nuk ka pësuar humbje në këto 3 takime të para, gjithsesi në lojë janë të tre rezultatet. Në fushë futuri vetëm për të fituar, por

pastaj se çfarë sjell ndeshja, është çështje tjetër.

**Objektivat?** Objektivat gjatë gjithë sezoneve, Kukësi i ka vetëm për të fituar trofe dhe këtë vit shpresoj që do të fitojmë trofe. Nuk bëj ndarje mes Kupës dhe titullit kampion,

por shpresoj që t'i marrim të dyja.

**Ekipi që duhet mundur?** Ekipet nuk kanë shumë diferencë në mes kështu që mund të fitojë secila ndaj secilës. E rëndësishme është që me çdo kundërshtar të futemi njëlloj dhe duhet të bëjmë maksimumin për të marrë më të mirë, pavarësisht emrit që kemi përballë.

**Ndryshimet që ka gjetur pas rikthimit?** Ndryshimi është që janë rritur të gjitha ekipet pa përjashtim. Më shumë janë përqendruar në aspektin profesional dhe këtë e shohim te rezultatet në Europë të ekipeve nga Kategoria Superiore. Si mendon se do të presin tifozët e Partizanit? Nuk besoj se do të ketë reagim negativ, sepse ato e dinë se futbollin i ka këto gjëra. Aшту siç është respekti im ndaj tyre shpresoj se do jete i njëjtë edhe nga ana e tyre që do të thotë gjithçka reciproke. Gjithsesi, unë ruaj kujtime të bukura nga ajo periudhë.

### MESFUSHORI I ATLETIKOS

## David Vija shkes për të çuar Saul te Barcelona

Të reja të rëndësishme për Barcelonën. Me skuadrën katalanase pritet të bashkohet shumë shpejt mesfushori i talentuar i Spanjës dhe Atletikos së Madridit, Saul Niguez. Sipas "Mundo Deportivo", Barcelona ka përparësi për të marrë këtë futbollist, pasi diçka e tillë është parashikuar

në një marrëveshje që në kohën kur nga katalanasit kaloi tek Atletiko e Madridit sulmuesi David Vila. Më saktë, sipas marrëveshjes, duhet që Atletiko të informojë Barcelonën, nëse një klub tjetër jep një ofertë më të mirë për çdo lojtar të ekipit nga

Madridi. Në një rast të tillë, Barcelona mund të japë të njëjtën ofertë për të marrë lojtarin e Atletikos. Klauzola e prishjes së kontratës për mesfushorin Saul Niguez, është 150 milionë euro dhe katalanasit janë të favorizuar për të marrë këtë futbollist.

### FIFA kundër klubeve të mëdha

## Gati revolucionit, jo më huazime pa limit të lojtarëve


FIFA kërkon të bëjë disa ndryshime në lidhje me merkaton e futbollistëve dhe aktualisht po sheh mundësinë për të vënë një limit në lidhje me lojtarët e huazuar nga klube të ndryshme. Rregulli i ri, që mund të ndryshojë merkaton në sezonet e ardhshme, sipas gjermanes "SportBild", parashikon një zvogëlim të numrit të lojtarëve të huazuar deri në 8. Ky ndryshim është studuar prej shumë kohësh, por do të aplikohet, nëse merr miratimin nga Komitetit Ekzekutiv i FIFA-

s. Në këtë rast, skuadrat e mëdha humbasin. Për klubet e mëdha europiane do të ishte një revolucion. Çelsi dhe Manchester Siti, për shembull, kanë respektivisht nga 40 dhe 28 lojtarë të shpërndarë në klube të ndryshme. Juventusi në Itali ka 26 lojtarë të shpërndarë nga 51 në total që

kishte regjistruar sezonin që shkoi për të gjitha kompeticionet. Duhet saktësuar fakti se, nëse rregulli i miratohet, përjashtohen në këtë rast lojtarët që janë nën 21 vjeç dhe që janë formuar në akademinë e çdo klubi dhe që kanë qenë nën kontratë për një periudhë të gjatë kohe.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Një kabanon helikopteri.
6. Janë diletantët.
13. Janë të përgjeshëm të tillë në arktik.
14. Ekstremit në duel.
16. Duhet respektuar në kohë.
17. Eshhtë skuadra.
19. Morsa pa kufij.
21. Fillojnë nazet.
22. Roje pa re.
23. Duhet të jetë reciprok një i tillë.
25. Një është edhe Dajti.
26. Pineda e Garcia Lorca-s.
27. Banushi që qe komik i yni.
28. Kanë feçkë të gjatë.
29. Inicialet e Harris aktor.
30. Eshhtë dëshirë fikse.
32. Gjysma e laikut.
34. Inicialet e Moravia-s.
36. Ndryshon çdo ditë.
37. Parajsa e humbur.

39. Kroger i Thomas Mann.
41. Janë kapo.
43. Mbyllin komentin.
44. Ka një shpejtësi fantastike.
48. Ekstremit në letër.
49. Një tis mjegulle.
51. Lindin në kokë.
53. Ngrihet nga të ftohtit.
54. Nuk shuhej dot nga Tantali.
55. Eshhtë vendi aderues.
56. Në hyrje të ambientit.

**VERTIKAL**

1. Në hyrje harkut.
2. Ishin grekët në Trojë.
3. Pjesëz mohuese.
4. Ka një qafë shumë të gjatë.
5. Inicialet e Duvall.
7. Fshehin fytyrat.
8. Inicialet e Fogazzaro-s.
9. Gjysmë tandem.
10. Mbyllin teatrot.
11. Shkroi Një jetë e Jezusit.
12. Eshhtë edhe ai i metrit.
15. Janë vegla për ngarkim.
18. I fundit ai i Bernardo Bertolucci-t
20. Emri i Magritte
22. Janë të dhënat jo zyrtare.
24. Eshhtë enë bakri.
25. Gustav kompozitor.
26. Një pjesë e memorialit.
27. Mbyllin koncerte.
31. Mbyllet me dorezë.
35. Nicholas, bomber te Chelsea.
35. Claude-Oscar pilot
38. Kufizojnë detyrat.
40. Fillojnë ideologjinë.
42. Një mjet transporti publik.
45. Rubinstein që qe balerinë.
46. Dhejtë angleze.
47. Matet pa kufij.
50. Janë të ndryshme në leje.
52. Hapet në fund.
53. Ekstremit në janar.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

1. Në mes të Edgar dhe Poe.
6. Lourdes i portugezëve.
12. Emri i parë i Fassbinder.
14. Janë edhe ato të fytyrës
15. Kuron pa zë.
16. Ishte komandanti si Çerçiz Topulli.
18. Në kokë të çdo njeriu.
19. Shuhet me pak ujë.
20. Janë ujëvarat.
22. Pak teatrale.
23. William teniste.
24. Diftong në kuotë.
25. Në fund majtas.
26. Janë besimtarë.
27. Rrallë është përgjysmë.
29. Hayworth që qe aktore
31. Eshhtë si vegël.
32. Eshhtë ajska e shoqërisë.
34. Akoma është ndryshe.


36. Janë katër në violinë.
38. Fillojnë illogarinë.
40. Ndryshe për latinët.
41. Agjencia evropiane e hapësirës.
42. Shuhet me pak ujë.
44. Në krye të komandës.
45. Një zakon i keq.
46. Merret në bankë.
48. Një pjesë e perëndimit.
49. Një ndjekës i një filozofi
50. Të parat në ambient.
51. Sampras i tenisit.

**VERTIKAL**


1. Inkasojnë para.
2. Tregohet një me kuotë.
3. Ruhet me dietë.
4. Fillojnë andej.
5. Këndon Laura non c'è.
6. Do të bëhen pemë.
7. Mund të jetë fotografik.
8. Filmi i parë shqiptar.
9. Inicialet e Reitman.
10. Xhemali që qe bariton.
11. Në atë vend.
13. Mund të jenë balistike.
14. Si të gjithë.
17. Një klasë si një tjetër.
21. Eshhtë i ndarë në Sure.
23. Fillojnë sefte.
26. Një fjalë gratis.
28. Janë efektet e padëshiruara të ndërmarjes.
30. Eshhtë halli.
33. Ishulli i Odiseut.
34. Tase e volejbolit.
35. Kishin mbret Decebalin.
37. Mund të jenë edhe gjaku.
39. Atomike ajo e Salvador Dali.
40. Bajat pa ekstremit.
43. Roth aktor
45. Në fillim të vitit.
47. Inicialet e Redford.
48. Fillojnë periudhën.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	M	O	K	A	K	F	E	S	T	A	T		
F	A	R	U	K	S	H	Q	Y	T	A	R	I	
T	L	V	A	I	E	A	N	A	M				
A	V	E	N	D	O	S	M	E	R	I	A		
M	E	R	G	E	N	A	R	E	T	R	G		
P	A	R	T	E	N	O	P	E	A	F	E	J	
K	O	B	A	L	T	E	K	L	A	N	A		
R	A	A	H	T	U	N	E	L	E	T			
M	E	L	R	T	I	L	O	J	A				
A	T	E	L	I	E	R	L	L	A	N	O		
R	I	T	I	T	I	D	G	R	I				
S	P	O	R	T	I	S	T	E	P	A	R		
K	U	P	A										
R	R	P	E	R	T	K	S	I	R	T	A	K	I
D	I	M	E	N	S	I	O	N	E	T	K	I	M
S	T	I	N	T	A	K	S	A	L	O	I	L	
Z	A	R	A	R	E	A	S	I	R	E	T		
Z	A	R	A	E	T	I	K	E	T	A			
N	A	S	T	K	O	R	R	J	A	O			
T	A	L	B	O	T	I	A	A	A	A			
I	D	E	A	K	Y	C	S	T	U	F	A		

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

		5			2				
1							4	6	
2					1			8	
3		2						1	9
		8			3				
					5	7			
5		3		6			2		
		7		2			9		6
			8		5				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	8	2	5	9	3	7	1	4
9	7	4	1	2	8	5	3	6
5	1	3	7	4	6	2	8	9
4	2	6	8	1	7	9	5	3
3	9	7	4	5	2	8	6	1
8	5	1	3	6	9	4	7	2
1	4	9	6	8	5	3	2	7
7	6	5	2	3	4	1	9	8
2	3	8	9	7	1	6	4	5

*Argëtim filozofik*

- Kujdesuni të ndëshkoni të metat tuaja, që të mos ndëshkoheni nga ato.
- Frutat e tua u poqën, por ti sje pjekur për frutat e tua.
- Ai që të ka lënduar ishte ose më i fortë ose më i dobët se ti. Nëse ai ishte më i dobët, ndjej keqardhje për atë. Nëse ishte më i fortë, ndjej keqardhje për veten tënde.
- Udhën e humbe që e humbe, por as të ecësh më nuk di.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	16	17		7	7	3	6	3	T	R	A	P	A	E	F	I	K	A	S			
1	7	2	10	3	5	1	6		4	1	6	H	E	R	O	I	Z	M	I	P	A	K	O
3	7	1	5	2	11	3	4	1	6		7	E	K	T	P	A	P	A	T	L			
3		1	12	2	9	8	4	1	6		7	S	P	E	R	A	N	D	O	R	I	A	
10	3	5	3		3	4	2	6	3	3		T	E	R	E	N	C	E	H	I	L	L	
12	9		6		9		8	5	3	5		D	E	T	E	K	T	I	V	I	E	K	S
1	18		3	9	3		5	R		1	9	A	N	E	U	A	N	M	A	T	I	A	
11	1	10	6	2		2	I		6	2	6	M	O	R	R	I	P	I		M	Z		
6	4	6		10	6	2	4	N	9		7	A	R	R	I	E	A	H	I	E			
1	6	3		19	3	4	9	G	3	5	10	R	E	A	L	S	E	L	L	E	R	S	
6	1	5	2	6	3	15		6	1	7	3	E	C	A	R	A	M	A	N	E	T	I	
6		7	2			16	2	6	3	5		T	R	A	K	T	I	A	A	Z	I	L	

*Thënie të mënçura*

- Ndonjëherë njerëzit hedhin diçka të mirë për diçka më të mirë, për të zbuluar më vonë se e mira ishte mjaft e mirë, dhe më e mira ende nuk ka ardhur.
- Ai që di, mes njerëzve kalon si mes kafshëve.
- Më frikëson më shumë një ushtri prej 100 delesh që u prin një luan, se sa një ushtri prej 100 luanësh që u prin një dele.
- Bëhuni si ora e saktë, por mos u bëni si ora që çdokush t'ju kurdisë.

